


AZEM DELIU:

Letërsia ka dënimin
fatlum që të jetë
produkt i një
përpyjekjeje që nuk
kryhet, nuk mbaron



Portreti nga Ina Lajthia

Intervistoi: Violeta Murati

POEZIA QË GUXON MË SHUMË...

**VISAR ZHITI
SHKRUAN
ASHTU SIÇ
JETON**

Nga Dr. Milutin Gjuričković

**I NATYRSHMI
DHE I
NATYRALIZUARI**

nga Fatbardh Amursi
(Rustemi)

BIBLIOTEKË



**LIRIKA
nga Roland Gjoza**



**“Lolita” nuk do
të botohej nëse
Nabokovi do ta
kishte shkruar
tani**

nga Lara Waddell

Frano Kulli dhe kodi i tij

Përshtypje leximi nga libri: “Kohë e përlyeme” (publicistikë)

nga Xhahid Bushati

In Memoriam: Aleksandër Koli



**PËRSHËNDETJA
E NËNËS**

Tregim nga Ljudmilla
Petrushevskaja

*Përktheu nga origjinali
Aleksandër Koli*

Shtatë fotografë shqiptarë gjenden në Shkodër, në kryeqytetin e dikurshëm të Shqipërisë, të ftuar nga Art House dhe Muzeu Marubi për të evokuar disa imazhe të thjeshta e të thella që i frymëzojnë

**François Cheval:
Himn spartan**

**Erotika e
Janis Ricos**

Eleana Zhako - përkthyesë

Azem Deliu

Letërsia ka dënimin fatlum që të jetë produkt i një përppjekjeje që nuk kryhet, nuk mbaron

Intervistoi: Violeta Murati

Nga një kërkim informacioni mbi ju: në moshën 16-vjeçare s'keni botuar asgjë, por ju quajnë "poet" në qytetin tuaj. Fillimisht shkruani poezi, me shumë pretendime letrare, madje në perspektivë të artikuluar qartë. Prezantoni në Kosovë, më 2012-ën, në një sallë leximi një punim letrar- shkencor, "Brilanca Kadare, stili, sukseset dhe zënkat". Punimi ishte befasi dhe më pas ju bëni "lëvizjen" tjetër duke i dërguar po në këtë vit një letër Komitetit të Nobelit për të nderuar shkrimtarin shqiptar, pra Kadarenë. Si e reflekton sot, ka një dritë që keni ndjekur në mënyrë intuitive, në ç'rugë kalon, ndjek, një shkrimtar...?

Është një hyrje mjaft e çuditshme në letërsi, por, për të qenë i singertë, s'më duket se ka hyrje të paçuditshme në letërsi. Letërsia në sytë e mi ka pretendime mjaft të mëdha për veten, prandaj është krejt e natyrshme që shkrimtari t'i kërkojë këto pretendime. Kur e them këtë, kam parasysh se letërsia, ashtu si artet në përgjithësi, nuk pranon "ushqim" të dobët, apo edhe mesatar. Këto dy lloje ushqimesh mund të shërbejnë që të krijohet ushqimi i vërtetë, por sallonet e mëdha, gostitë e mëdha të letërsisë, zhvillohen vetëm nga majat e saj. Ajo i kërkon vetvetiu majat, prandaj shkrimtarit të ri, që të jetë shkrimtar i mirë i së ardhmes, i duhet t'i synojë ato maja. Lidhja ime e hershme me Kadarenë si shkrimtar, me thënë të vërtetën atëherë më shumë si imazh, ishte e tillë: e mendoja për majë të letërsisë dhe këtë majë që e synoja, nuk do ta lëshoja me asnjë kusht, sepse isha i bindur se vetëm në majë zhvillohet dialogu i vërtetë dhe i rëndësishëm letrar.

Ka qenë një këmbëngulje për të hyrë, për ta njohur letërsinë, shkrimtarin; çfarë bote keni imagjinuar në fillim dhe çfarë shihnit më përtej? Keni pasur një vizion, një perspektivë për këtë, për veten tuaj?

Po, patjetër! Mendoja se tashmë isha shkrimtar, veçse bota s'e kishte marrë vesh akoma. Dhe në sytë e mi ishte bota ajo që po humbiste, jo unë. Isha një Don Kishot i vogël, për të përdorur terma sa më të butë. Por kjo, sado që mund të jetë e pavërtetë, në fillim është shumë, shumë e dobishme: i jep shkrimtarit një mbrojtje të jashtëzakonshme nga bota. Është një mekanizëm mjaft i shëndetshëm që e zhvillon letërsinë, me kusht që të dihet ku mbaron vetëmashtrimi, nëse ai është i tillë. Jo gjithmonë na ka faj bota për atë që jemi, për gabimet që bëjmë. Njerëzit e mirë, për mendimin tim, i dallon veçanërisht aftësia për të reflektuar mbi veten. Letërsia e përmbush kaq mirë këtë "mision": është një art kaq i singertë, që jepet përmes trillimeve. Ironike? Siç janë shumica e të vërtetave të mëdha.

Markezi, duke tërhequr vëmendjen për krijuesit e rinj që në fillesa priren nga intelektualizmi, thoshte se vetëm kur u rikthye në vendlindje (pas ikjes në moshën 6-vjeçare), e kuptoi se ç'është letërsia, si shkruhej. Ju keni historinë tuaj për këtë...?

Secili shkrimtar e ka historinë e vet për këtë. Por, t'ju them të drejtën, për dallimin e madh prej Markezit, unë s'e di ç'është letërsia dhe si shkruhet. E di si shkruaj unë dhe kjo më mjafton për ta përjetuar letërsinë si pjesë të vetes. Por, që ta përjetoj veten si pjesë të letërsisë do të duhet kohë. Në një formë të çuditshme, shpresoj që kjo të mos më ndodhë.

Një shkrimtar i angazhuar! Çfarë ju thotë sot, provokon apo mbaron kauza? Ku e shihni veten?

Kritika majtiste sidomos, në qëndrimin e saj, për mendimin tim krejt arbitrar, ndaj Ernesto Sabatos, i ka mëshuar fort "faktit" se ky i fundit i ka romanet të thëlluara në individualitet dhe së këndejmi, nuk paraqet shoqërinë e kohës së tij, apo çfarëdo kohe. E vërteta, për mendimin tim, është se e vetmja mënyrë

për ta paraqitur shoqërinë e cilësdo kohë është, në fakt, hyrja sa më thellë në skutat e një personi të vetëm. Sepse, sa më thellë të hysh në individualitet, aq më shumë ke gjasa për të gjetur të përbashkëta të pamohueshme njerëzore. Por, çudia e madhe është se akuza që i bëhej Sabatos ishte pikërisht që nuk ishte "shkrimtar i angazhuar". Më falni? Në syrin tim, Sabato është shkrimtar i angazhuar, si çdo shkrimtar tjetër. Një shkrimtar nuk mund të jetë i paangazhuar, por shkrimtari nuk është i angazhuar siç duan të tjerët të jetë. Librat e tij nuk janë pankarta, as manifeste, as fletushka ideologjike për të cilat bëhet edhe aktivizëm fizik: janë dhoma meditimimi në të cilat gjen kuptim intimiteti njerëzor. Por ata s'e duan këtë gjë. E duan shkrimtarin aktiv se s'bën. Kur iu thua se është aktiv, ankohen se nuk është aktiv sipas definimit të tyre të aktivizmit. Atëherë, të nderuar, ndërrojeni definimin, sepse shkrimtarin s'e ndërroni dot.

Ngjarjet e romanit tuaj të parë, "Puthësi i paligjshëm", zhvillohen në një shtet ku privatësia nuk ekziston, ku identiteti është në krizë të vazhdueshme dhe ku gjithkush, gjithkund, është në rrezik. I shkruar në moshën 20-vjeçare, natyrshëm ka shumë komplekse për t'u sqaruar mbi këtë libër: pse një portret kaq besnik i një diktature, pse asaj të Shqipërisë, ç'është për një të ri që sapo nis letërsinë me veprën e parë të hidhet në një rrëfim kaq dinamik, me ankthin e karakterit...?

Çdo shoqëri ka elemente tiranike, edhe kjo jona. Të rinjtë kapin ekstreme disa herë dhe një të tillë e kam kapur unë me "Puthësin e paligjshëm". Nuk ka të bëjë shumë me shtetin në të cilin po jetoja, sa ç'ka të bëjë me llojin e letërsisë që e pëlqoja: "1984" dhe "Ferma e kafshëve" të Orwell-it, "Procesi" i Kafkës, "Pallati i ëndrrave" i Kadaresë etj. Pra, ishte ushtrim letrar, pa tendenca "aktivizmi" politik. Por, po të jetë libër i aftë që të ngrejë edhe pikëpyetje politike, atëherë jam i lumtur për lexuesin tim.

I riu Ivan Shollobov, banor i Republikës së Moralitës, ka puthur katër minuta përpara orarit të caktuar të dashurën e tij, Rinën... Në një botë të lirë nuk është kurrë një shkak, por në diktaturë është më se "normale" – pse ky asosacion për të paraqitur në kushte lirie një anormalitet, mungesë lirie?

Kur në këtë përshkrim përmendet togfjalëshi "botë e lirë", nuk jam i sigurt nëse e ka kuptimin e botës së sotme. Qytetërimi i sotëm është relativisht i lirë, por kjo s'do të thotë, siç thashë më lart, që nuk ka elemente tiranike. Mendoj se pikëpyetjet për botën që s'e kemi ende, duhet të ngrihen në diskutim, ashtu që ajo botë, nëse vlerësojmë që s'na duhet, të mos vijë kurrë.

Ne nuk jemi në një botë ku njerëzit dënohen për puthje (jo në Europë të paktën), por nëse diskutimi mbyllet, ajo edhe mund të vijë. S'ka gjë që e ndalon Europën të prodhojë një Hitler të ri, sidomos me ngritjen, jashtëzakonisht shqetësuese, të populizmit nacionalist kohëve të fundit.

Depersonalizimi i njeriut në atë që e mban në një lidhje të shenjtë, siç është dashuria – si e beson këtë?

E vështirë të flas për këtë. Dashuria, si edhe letërsia, natyrshëm e luftojnë diktaturën, besoj dikur. Tani besoj se letërsia po, sa për dashurinë, ajo di të jetë diktaturë në vetë.

Libri është imagjinatë e pastër, s'ka lidhje me jetën reale, por ndoshta ka pasur ndikim?

Patjetër, ndikimet që u përmendën më lart dhe të tjera që do të përmenden apo s'do të përmenden kurrë. Varësisht nga kujtesa dhe singëriteti im.

Nga jeni inspiruar – i rëndësishëm si shqetësim – por, në fakt, a mund të shpjegohet inspirimi, a na vë në dyshim kjo pjesë të vërtetën? Pse e shkruat, çfarë donit të tregonit me këtë roman, nga vështrimi juaj çfarë është shqetësim mbi shoqërinë?

Doja të ndërtoja një vepër arti që i përmbush kriteret e mia për artin. Ato janë të thjeshta: të përdoren trillime që, sa më bukur që është e mundshme, të thuhet të





vërteta. Këtë formulim pak a shumë e kam parë për të parën herë në filmin V for Venedetta. Tepër e vërtetë më ka ngjarë. Sot më ngjan vetëm “e vërtetë”.

Ivan Shollohov, Smolinski, janë dy personazhet e para, të lindur nga dy librat tuaj të parë, emra të huaj, – pse jo na realiteti shqiptar apo bashkëkohësia juaj?

Sepse dua të vë theksin mbi diçka që shpesh ngjan se mohohet: njeriu, kudo në botë e kudo në kohë, ka një set të ngjashëm shqetësimesh. Kozmetikak ndryshojnë, thelbi i tij është po ai. Polaku, shqiptari, gjermani, rusi, kanë të gjithë shqetësime themelore të ngjashme. Shqetësimet përtejthelore dallojnë, por ato janë më larg thelbit. Mua më intereson thelbi, sepse është më i vërtetë se gjithçka tjetër.

Mund të mos jetë kurrë shkak ndëshkimi për asnjë botë të lirë. Por është më se mjaftueshëm për çdo diktaturë. Njëzetvjeçari nga Skënderaj, Azem Deliu, ironik dhe lakonik, me një prozë të thjeshtë, ka tentuar të sjellë një copë pasqyrë të botës së absurdit, ku njeriu ka humbur fytyrën, ka humbur emrin dhe ka përfunduar në një numër... Është kritikë, zëra të paktë, por kam parë që kritika këtu në Shqipëri ju ka marrë seriozisht... Sa ka vlejtur për ju?

Po, kritika në Shqipëri më ka marrë seriozisht dhe më ka nderuar mjaft. Duke qenë se kjo nuk ka ndodhur shumë në Kosovë, ka qenë dyfish e vlefshme për mua. Megjithatë, ka një kënaqësi të ndjeshme për sedrën e shkrimtarit akti i leximit dhe i analizës nga një lexues i parëndomtë, siç është kritikë.

Jam kurioze të di, keni një qasje për sot, kur ju mund të zbuloni gjurmë, shenja autoritarizmi, pra të atyre që quhen njollat ideologjike...? Për vende si tonat, kjo ka rëndësi për kujtesën, apo jo? Në moshën tuaj, si mund të ndihet kjo?

Kam shumë shqetësime për lirinë e shprehjes. Aty sulmon së pari autoritarizmi. Një vend pa këtë liri është vend i vdekur dhe Shqipëria, shumë më tepër se Kosova disa herë, po i hyn këtij rreziku.

“Pra, propozoj që të votojmë sot për ndalimin e ideologjisë së rrezikshme të quajtur dashuri, që dita-

ditës po infekton më shumë shokët dhe shoqet e masës popullore”. Pas kësaj, me shprehje habie nëpër fytyrë, të ngjashme me fytyrat e shkencëtarëve pasi kanë zbuluar dukurinë e re që do të ndryshojë njerëzimin, ata shprehën ngazëllimin e tyre për fjalimin magjepsës të deputetit të ri. Dukej se nëpër mendjet dhe zemrat e tyre, nëpër ulëset e drunjta mbi shpinoren e të cilave shkruhej ‘Rroftë Lideri’, mbi pluhurin që rrallë lejohet, kishte pushuar prej kohësh ideja e këtij ndalimi. Por ata, për kushedi çarsye, nuk e kishin vërejtur. Dhe ja, doli një deputet, më i riu i të gjithëve, që t’ua hapte sytë. Përqafimet dhe shtrëngimet e duarve nuk kishin të sosur. – Ky është një fragment pikant nga romani “Puthësi...”. Mendoni se kohët janë po ato, të pandryshuara, që historia përsëritet?

Siç e thashë, ka një thelb njerëzor që mbetet i pandryshueshëm. Ai thelb, siç prodhon të njëjtat të mira, di të prodhojë të njëjtat rreziqe në rrotën e historisë. Prandaj është themelore, jo vetëm ta dimë që historia mund të përsëritet, por edhe të mos e lejojmë të ndodhë.

“Puthësi i paligjshëm” u botua edhe në gjuhën angleze. Shtypi francez ju ka quajtur “autorin e madh të vendit të vogël” dhe “yllin e ri të letërsisë europiane...” Çfarë efekti kanë pasur mbi ju këto vlerësime?

Më lëmojnë shumë sedrën kur ndodhin, por përpiqem t’i largoj nga mendja një orë e më parë, sepse dinë të ndikojnë keq dhe ky ndikim që mund të jetë i pavërejtshëm, të ketë dëme afatgjata për një shkrimtar.

Në librin e dytë, “Shënimet e krimbit Smolinski”, shkrimtarin e vini në qendër, duke e sjellë nga Polonia në Kosovë, në një rezidencë, por ndeshet me mentalitetin e pasluftës, që përkon edhe me momentet historike të Polonisë postkomuniste. Pas tri dekadash që ka rënë komunizmi, jepni drejtpërdrejt si mendësi te shkrimtari identitetin e tij seksual, duke kapërcyer në roman nga mosha romanore 38-vjeçare në një adoleshent 18-vjeçar. Përkthyesja e shqipes në polonisht, Dorota Horodyska, ka thënë: po të përkthehej ky roman në Poloni, do të shkaktonte problem. Çfarë përfaqëson për ju ky moment në roman?

Për këtë roman më duhej një strukturë që mendjeve prapanike do t’iu ngjajë si provokim. Letërsia as nuk e ka detyrimin të ketë konsiderata të tilla, që të respektojë një hierarki tradicionale, për mosrespektimin e së cilës Dorota ka thënë se, nëse botohet në Varshavë, do të sjellë problem. Dhe mund të them se mund të botohet në Varshavë dhe mund të sjellë probleme, unë nuk kam bërë asnjë provokim të qëllimshëm, por, nga ana tjetër, nuk jam njeri që më bën përshtypje nëse dikush më provokon për nga letërsia.

Letërsia nuk ka kurrfarë konsideratash, as morale, as religjioze, as tradicionale dhe vetëm si e tillë është letërsia e mirë. E di se prej Platonit e këtej ka debat se çfarë është letërsia e mirë ose jo. Dhe unë vetë nuk kam mundur deri sot të gjej ndonjë baraspeshë të asaj se çfarë mund të jetë letërsia e mirë. Por kam vetëm një ide të pandryshueshme, se letërsia e mirë është letërsia e singertë, nuk e helmon veten me kohën e korrektesës politike. Të mos i them ca gjëra, sepse lexuesi i kësaj kohe apo i asaj kohe nuk ka dëshirë t’i dëgjojë. Unë nuk kam pikën e konsideratës për këtë gjë. Në anën tjetër, identiteti seksual i personazhit më ka interesuar që të bëj një paradigmë dhe të jap një portret të Polonisë së viteve ’90, influencuar jashtëzakonisht shumë edhe nga kisha dhe që këta njerëz i keqtrajtonin. Këtë e bëra për arsye që të sjell një imazh se nuk kanë qenë vetëm shqiptarët që ishin keq pas komunizmit. Në qendër të Europës Qendrore, në Varshavën që disa herë e shohim si model, ose të paktën e shohim si një nga modelet, kur flasim për kulturën, mund të ketë ndodhur, dhe ka ndodhur, një trajtim i tillë. Ka evidencë historike për këtë. Nga ana tjetër, nuk pres që ndeshja e traditës me risinë, sidomos kur bie fjala te besimet kolektive, të jetë një gjë e këndshme. S’ka qenë kurrë dhe s’do të jetë kurrë. Letërsia as nuk e ka, e përsëris, detyrimin të ketë konsiderata të tilla.

Pse keni zgjedhur një mjedis polak për librin tuaj? Ka ekzistuar ndonjë “frikë” për këtë temë kaq alarmante, siç është shprehja, liria e shprehjes?

Të thuash sot në Kosovë se mungon përmasa e shprehjes, është mjaft shqetësuese për një demokraci. Duket si një alarm, por këtu nuk përbën alarm. Në Poloni, të paktën, e kanë ruajtur këtë sens se kjo përbën alarm. Përbën alarm, përbën arsye për t’u ngritur, për të protestuar dhe për të ngritur çështjen në publik. Këtu nuk përbën më alarm, këtu njerëzit keqtrajtohen për diçka që mund të thonë, që tingëllon të paktën më tepër ekstravagante sesa do t’i pëlqente masës së gjerë të tingëllonte nga dikush, autoriteti i Kosovës. Dhe, për çudi, nuk përbën më lajm, nuk përbën ndonjë habi, njerëzit e tejkalojnë me një shprehje shpesh “të zgjuar”, e “ka lyp vetë”, këso paralelizmash. Nuk e kam shkruar këtë libër në Poloni sepse kam pasur frikë ta shkruaj në Kosovë, por e përmenda, në Kosovë nuk do të përbënte më paradoksin e mjaftueshëm për t’u ngritur në nivel letërsie. Në Poloni e përbën, sepse shtrati kulturor që kanë ata, është ndikuar fatmirësisht jo vetëm nga katolicizmi. Ka diçka në Poloni që është e pavarur nga Kisha dhe ajo është muzika, kultura, letërsia. Unë kam thënë një gjë në Poloni që është bërë pak e madhe, kam thënë që Polonia, për të mirën e vet, në radhë të parë, do të ishte mirë që në vend që të identifikohet me Papën, të identifikohet me Gombrowicz. Witold Gombrowicz është nga shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit të kaluar dhe kam qenë shumë i kënaqur që e kam lexuar dhe e kam zbuluar para se të shkoja në Poloni. Por këto përbëjnë lajm atje, sepse i tillë është shtrati kulturor.

Atje përbën paradoks që një njeri të persekutohet për bindjen e tij. Jo vetëm në Kosovë, por në Ballkan në përgjithësi, kjo nuk përbën shumë çudi. Për shembull, unë kam qenë për rezidencë në Beograd. Atje njerëzit persekutohen, sepse kanë një mendim të caktuar për një klasë politike që është shumë e ndërlikuar me një nacionalizëm bazuar në mite e përralla, që për klasën politike është histori. Por është një sistem që ekziston. Në Ballkan nuk përbën çudi. Në botë përbën çudi.

Dhe prandaj edhe letërsia merr atë që do të mund ta çudiste botën, shpesh e shndërron në një të rëndomtë; nëse autori është i mirë, e shndërron në diçka të veçantë. Shpresa është për këtë, patjetër.

Dua të ndaj me ju një vlerësim që është dhënë në një gazetë gjermane, i shënuar në ribotimin e librit, që mendoj se është dinjitoz për një autor të ri: Azem Deliu, kritikët guximshëm ju kanë quajtur “Dostojevski i ri erdhi në një rrëfim kafkian mbi raportet e babait me të birin”. Pa dyshim, mbi këtë citim çdo shkrimtar i ri, me dy libra të botuar, do të përkëdhelej, por në paradoks libri anatemon këtë përkëdheli që një autor i ri mund të ketë mbi veten. Ju shënoni: një gazetar kulture që do të bëhet shkrimtar dhe ngre dilemën, thotë: më mirë një krimb i pandershëm apo shkrimtar! Mbi këtë kontradiktë që ju e përplasni shumë ashpër “ëndrrën e shkrimtarit”, sidomos te një i ri, çfarë mendësie krijoni? Me letërsinë çfarë mendoni se realizoni, krijoni. Çfarë ka ndodhur me përvojat e mëparshme letrare, më vjen ndoshta një analogji nga libri? Jeni zhgënjyer, nuk jeni ngopur me letërsinë e vendit tuaj, apo ju duket e përbindshme letërsia, njeriu...?

Mbi krahasimin që bën shtypi gjerman me Dostojevskin apo mbi pyetjen nëse jam i kënaqur me letërsinë e vendit tim, ka linjë që i bashkon të dyja, besoj unë. Është shumë keq për një shkrimtar që të jetë i kënaqur me letërsinë e vendit të vet. Që të mos ndiejë se lapsi i tij mund t’i japë një ndryshim, një freskim, një model për t’u ndjekur nga brezat e ardhshëm. Unë kisha modelet e mia që i ndoqa dhe i ndjek, që të mos kem prirjen që të ofroj atë ndryshimin që publiku me ose pa vetëdije e kërkon. Për shembull, nuk mjafton për publikun që ne botojmë në kopertinë lëvdatën e një kritiku gjerman. Mund të jetë shumë përkëdhelëse dhe për mua është, por nuk mjafton për lexuesin. Ai e blen, ndoshta për këtë citim, që është mjaft mitizues, por nëse libri brenda nuk ofron argument për këtë që është thënë në kopertinë, lexuesi jo vetëm që do të ndahet i zhgënjyer, por do të jetë shumë më refuzues dhe më analitik, kur në kopertina librash të tjerë do të botohen vlerësime të tilla për autorë të rinj. Unë nuk di ç’të them. Në njërën anë, kjo më gëzon shumë për faktin që shtypi i huaj përmend emra të mëdhenj në raport me mua... Gazetat polake përmendnin Kafkën, Kadarenë, Dostojevskin, autorë librat e të cilëve i kam lexuar, i kam dashur gjithmonë e do të vazhdoj t’i dua e t’i idealizoj për aq sa mund t’i idealizosh kur fillon të merresh me letërsinë si profesion.

Por kjo të vë edhe në një presion mbi atë që

përmenda më parë. Kur ju i lexoni publikut nga një gazetë gjermane që krahason një autor të ri shqiptar me Dostojevskin, publiku me të drejtë të plotë do të presë të lexojë diçka shumë më të madhe sesa atë që lexon çdo ditë. A përbën ky roman diçka shumë të madhe sesa njeriu lexon çdo ditë? Unë nuk e di. Shpresoj shumë që për një pjesë të publikut ta përbëjë, por nuk jam i sigurt. Pra, jam në këtë ndërmjet, siç e thashë. Ju në fillim thatë mjaft mirë, pothuajse burrë – jam në pothuajse, jam vazhdimisht në pothuajse, pothuajse shkrimtar.

Jam pothuajse dikush që shtypi e krahason me këtë apo atë... dhe kjo pothuajse, ndonëse mund të duket improvizuese, nuk është fare ashtu. Është thjesht sinjalistikë e një përpjekjeje të vazhdueshme që nuk mbaron kurrë. Jam pothuajse shkrimtar, sepse shkrimtar me tamam nuk do të bëhem kurrë dhe është ajo që i vlen letërsisë, është përpjekja për të dalë nga kjo pothuajse... Unë besoj se kjo është më shumë një përpjekje. Libri që kam në dorë është një përpjekje më shumë. Librat e ardhshëm do të jenë përpjekje më shumë. Por letërsia ka dënimin fatlum që të jetë produkt i një përpjekjeje që nuk kryhet, nuk mbaron.

Në fakt, këtu më vjen direkt pyetja: atëherë, pse është dëshpëruese nofka e përdorur nga ju, pse ky shkrimtar, shkrimtari një “krimb i pandershëm”?

Është dëshpëruese, sepse është një nofkë që njeriu me vetëbesimin e tij jashtëzakonisht të ulët ia ka thënë vetes përpara se ta dëgjojë nga të tjerët. Dhe këtu thuhet: njeriu i merr seriozisht veç ato që ia ka thënë vetes para se t’ia thonë të tjerë. Nëse të tjerët thonë se ti je krimb i pandershëm, e të thonë plot e përplot nofka të tjera negative, me shumë gjasë ti do t’i marrësh seriozisht veç nëse ka diçka në ato nofka që ty të ngjan diçka e vërtetë për veten tënde. Pse është kaq dëshpëruese, pse është kaq serioze, sepse Pioter Smolinski përpara se t’ia thonë të tjerët ia ka thënë vetvetes, sepse ai beson që është “krimb i pandershëm” dhe beson deri diku që është shkrimtar, pra pothuajse beson, përsëri.

Kjo ndeshje, në një rrethanë normale, për një njeri normal, po të pyesësh: më mirë një krimb i pandershëm apo një shkrimtar i njohur, patjetër që të gjithë do të thonë shkrimtari i njohur. Atëherë, më falni: të jesh shkrimtar i njohur, patjetër je një krimb i pandershëm! E pashmangshme. Një shkrimtar i njohur nuk mund të jetë tjetër, përveçse edhe krimbi pandershëm. Sepse një shkrimtar i njohur nuk mund të jetë i tillë. Një shkrimtar i madh nuk mund të jetë i tillë pa dilemën e vazhdueshme mbi moralitetin e vet. Para se të jetë i aftë të dilemojë, të ngrejë dilema, mbi moralitetin e shoqërisë. Nëse njerëzit kujtojnë se mes shkrimtarit të madh dhe krimbit të pandershëm duhet të bëhet një zgjedhje, unë them se zgjedhja është formale për shkak të librit, për nevojë të librit. Por kjo nuk është zgjedhje, kjo është një paketë e plotë që shkon bashkë: dikush që do të jetë shkrimtar i njohur, do të jetë patjetër edhe krimbi i pandershëm.

Një fëmijë, lexues i mundshëm i së ardhmes, në takimin në Prishtinë ju bëri një pyetje të drejtpërdrejtë: A ke tregu për veten tënde apo e ke shpik vetë tregimin? Të rriturit këtë pyetje e komplikojnë me teori të krijimit. Por ka diçka kurioze për ju si shkrimtar i ri, a është personale apo e motivuar nga vetë autori, ndërsa a ke jetuar vetë apo e ke fantazuar?

Ky roman nuk është bazuar mbi jetën time, por mbi jetën e një shkrimtari polak që nuk ka ekzistuar kurrë. Por i vendosur në realitetin polak që ka ekzistuar. Këtë përgjigje që po ta them unë, libri s’është i bazuar në jetën time, do ta quajë gënjeshtër në vitin 2031 kur ta lexojë ai lexues i ardhshëm.

Një fragment: “Nuk është shumë e vështirë të thuash se Prishtina është shumë e bukur, por është kaotike si arkitekturë. Më kujtohet që njëherë gjatë studimeve profesori i historisë së artit, M. G., më pati thënë se



është e çuditshme se si arkitektura kaotike e vendeve ku jetojnë, shënjon edhe mentalitetin kaotik të popujve. Jo gjithmonë, natyrisht, sqaronte profesori që të mos keqkuptohej. Megjithatë, unë nuk kam hasur deri sot në ndonjë përjashtim. Kjo megjithatë mua më ngjante si eppur si muove e famshme e Galileut që pasi ishte ndeshur me gjyqin e kishës dhe kishte pranuar se Dielli sillej rreth Tokës dhe e kundërta, kishte thënë në të dalë të sallës eppur si muove... - mbyllet - profesori nuk e kishte pasur parasysh këtë vend të vogël në Ballkan”. Në mënyrë të natyrshme, do ju kërkoja pse nuk e ke botuar në Prishtinë, por në Tiranë. Ç’vend zë Prishtina tek ju? Prishtina zë tek unë vendin më të rëndësishëm, vendin e studimeve, të pjekjes intelektuale, si dhe vendin e ndeshjes me plot paragjykime që nuk më kanë pëlqyer, por janë. Ndërkaq, pse e kam botuar librin në Tiranë dhe jo në Prishtinë, përgjigjja është e thjeshtë: kam zgjedhur botuesin dhe jo qytetin. Kam zgjedhur Onufrin dhe jo Tiranën. Nuk e kam zgjedhur në kundërshtim me asnjë botues të Prishtinës, por kam zgjedhur një botues që e kam respektuar shumë për përmbajtjen dhe atë çfarë sjell në tregun shqipfolës të letërsisë.

Planet për letërsinë?

Goxha të thjeshta. Të vazhdoj të bëj letërsinë time dhe ta mbaj veten sa më larg ndikimeve jo të mira. Me kusht që paraprakisht i kam identifikuar ndikimet jo të mira: këtu është dreqi. Nuk është vështirë të luftosh, e vështirë është ta kuptosh problemin.

Mënyrat e reja të promovimit: keni përdorur shumë rrjetet sociale, por aty nuk ka audiencë të zgjedhur... si mundet? Çfarë rreziku ndien?

Po i përdor çdo ditë e më pak. Janë të mira për promovim, por janë tepër të zhurmshme. E kam të vështirë ta duroj zhurmën.

Si ka qenë pritshmëria e lexuesve, të cilët mendoj se kanë thyer klishtë për të kërkuar vetëm autorë të mirë, apo autorë të bombarduar nga mediat?

Besoj se lexuesit po kërkojnë letërsi të mirë dhe kjo duhet të na gëzojë, sidomos nëse besojmë se mund t’ua ofrojmë këtë letërsi. Lexuesi do ta kërkojë gjithmonë edhe kiçin. Por, fakti që edhe letërsia e mirë është në kombinim, më jep një shpresë goxha të lartë.

Sa besoni te koha e librit?


Jam fanatik. Besoj se çdo kohë është kohë e librit. Edhe më të errëta e kohëve, kthehen në kohë të librit.



Frano Kulli dhe kodi i tij

*-Përshtypje leximi nga libri: "Kohë e përlyeme" (publicistikë) të
autorit Frano Kulli, Botimet Fishta, Lezhë 2018-*

nga Xhahid Bushati



Me një përvojë të pasur në fushën e gazetarisë, Frano Kulli e pasuron më tej publicistikën shqiptare me librin "Kohë e përlyeme". Titulli i librit është një simbolikë e marrë nga realiteti a më tej tij, jeton si në diakroni ashtu edhe në sinkroni. Më theks aktual, i shtrirë në kohësi. Kohësi, që, për vetë natyrën e saj zhvillimore të realitetit ekzistues do të vazhdojë gjatë si gjendje, ekzistencë e marrëdhënie. Nga ana tjetër, titulli është i gjetur edhe poetikisht, me urtësi mendimi dhe rrënjë tradite. Përsëri, dua të flas për titullin. Ai shpërfaqet në në të gjitha pjesët, që autori i ka emërtuar në mënyrë kuptimplote, si: "Kokëderrat" e kënaqun dhe... "Sokrati" i vuejtun (pjesa e parë), "Fishta... dhe hijet përreth" (pjesa e dytë), "Martirët dhe ndërgjegjja jonë e përlyeme" (pjesa e tretë), "Tymnajë, show dhe kohë e çmendur" (pjesa e katërt). Si në leximin formal dhe në

atë thelbësor, libri ruan konfiguracionin dhe zbërthimin detajues të titullit. Pra, mbetet e njëjta linjë me titullin: marrëdhënia me kohën dhe me njerëzit. Në gjithë lëndën e tekstit gjejmë formulimin historiko-aktual të realitetit që ruan dimensionin e tij, e që autori përcjellë dhe e shënjon me mesazhin: Koha nuk mallkohet, sepse ne e krijojmë atë vetë.

Lënda e tekstit ka një mozaik problemesh, dukurish e fenomenesh, që, për nga mënyra se si konceptohen dhe shtrohen si platformë apo analizohen i takojnë një gazetarie të angazhuar, që Franoja e kryen më së miri. Si të thuash e ka të veten këtë lloj gazetarie. Brenda hapësirës së shkrimeve "shëtisin" mikrotëma, këto po të shikohen së jashtmi, por në të vërtetë janë makro, të rëndësishme dhe thelbësore. Sepse materialet rrëfehen me temë nga historia apo nga aktualiteti,

apo nga plot dukuri që lindën dhe gëluan në këto vite tranzicioni. Franoja përmes gazetarisë së tij me një strukturë analitike sjellë kujtesën. Vetë, kujtesa është historike, kulturore dhe shënjuese. Mos-harresa nuk e venit vlerën, por i jep asaj dimension njerëzor dhe ekzistencë. Ndaj, çdo shkrim është një copëz realiteti: i largët, i afërt dhe i përditshëm. Ndaj, çdo shkrim është një rrëfim, ku paraqitet qartazi realitet, kontribut, adhurim, respekt ndaj vlerave dhe të mos-vdekjes së tyre. Franoja ka si veçori të kodit të tij gazetaresk që i paraqet shkrimet me një shumëgjyreshmëri, me mjetet e duhura stilistike e sintaksë poetike, por që kanë si materie: ironi, frazeologji, urtësi, brengë, dëshpërim, shpresë dhe qëndrim. Për këtë arsye trajtimi i çdo problemi në fjalë paraqitet në plotësinë e tij. Duke qenë i tillë, Franoja është i përgatitur me të gjithë argumentet e tij, që i vë në funksion të boshtit kryesor të çdo shkrimi. Është i kujdesshëm për çdo detaj, i cili krahas elementeve të tjerë, e ka një rol, e një funksion të qëllimshëm.

Franoja është ai profil gazetari që në shkrimet e tij nuk bën "çudira", por merret me njerëzit, me marrëdhënien e tyre me kohën, merret me dukuritë e përditshme edhe pse në dukje duken të vogla apo të thjeshta. Pra, realiteti paraqitet me këto lloj pamjesh. Kjo është arsyeja që shkrimet kanë në themel reflektimin e të vërtetave të realitetit ekzistues. Edhe pse një gazetari e angazhuar, nuk mungojnë humori e ironia, polemika dhe perspektiva.

Franoja është kujdesshëm që materiali të jetë i freskët dhe të ketë kompozicion të ngjeshur, solid; me fjalor të zgjedhur e plot kulturë, larg banalitetit e rëndomtësisë së provincializmave. Të gjithë këto tregues flasin për një interes, ëndje dhe këndshmëri për t'i lexuar. Janë plot brumë.

Si përfundim profili i librit "Kohë e përlyeme", mund të them se i përgjigjet natyrës dhe guximit krijues të Franos. Kjo është arsyeja që, edhe pse si libër i parë, gazetari Frano Kulli e ka kuroreзуar aktin e tij krijues me dinjitet dhe në një rrugë të suksesshme. Në këtë libër shndrit origjinalja, origjinaliteti dhe mjeshtria sa e fjalës aq dhe e rrëfimit interesant.


Shkodër, tetor 2019



Dallimi midis dy romaneve të Gazmend Kapllanit" është i një difference të tillë, si të krahasosh një gurëgdhendës me një skulptor. "I keqi i vetes" nuk ngrihet, si një kat mbi të parin, por e zhyt romanin paraardhës "Ditar i shkurtër kufijsh" në një bodrum të tijin.

I NATYRSHMI DHE I NATYRALIZUARI

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)



Portreti nga Ina Lajthia

Teksa bëja fërc-fërc me pultin, edhe si një shkarkim nervash ky huq, në një stacion grek, mu shfaq Gazmend Kapllani, i ftuar në një debat televiziv. Ndala kërkimin, por jo kërsërinë. Përpqesha të merrja me mend se çfarë thuhej dhe e ndoqa emisionin deri në fund, pavarësisht mosnjohjes së gjuhës. Më kapi vetvetiu një si ndjenjë detyre, si e si të mos e lija vetëm bashkëqytetarin tim. Mos po i ngjaja personazhit të tij provincial, Frederikut, e patë çunin e lagjes tek greku mbrëmë opo orator i mbaruar, dhe ai: mos po më dukej si personazhi tjetër i tij, Karli kozmopolit, indiferent ndaj impenjimit të të vetëve? Frederiku dhe Karli janë vëllezër, por pa vëllazëri. Në mos përligjin shprehjen: "Vëllai është "armiku", që ta bën nëna." Frederiku, mjek në morgun e qytetit, i qendron linjës së babait, mësues marksizmi ky, i cili nuk e tradhëton vendlindjen, ndërsa Karli, poliglot, i linjës së nënës, mësuese gjeografie kjo: i cili vuan nga sëmundja e ikjes. Si të quheshin ndryshe: njeri "bërthamë e atomit" dhe tjetri "elektron i lirë". Karli dhe nëna e vetvuarë ishte kundër regjimit, ndërsa Frederiku me babanë e mbronin atë. (Një situatë groteske, po ta mendosh që Marksi të mos e honepste Engëlsin?) Frederiku: i tabanit, mëmëdhetar i afishuar, ndërsa Karli, ku rafsha mos u vrafsha, me një atdhetarizëm në zbehje. Gjithsesi, një kozmopolit i lindur me dilema tribale, duke më kujtuar një poliglot tjetër, Egerem bej Vlorën, ikanak edhe ky, i cili shkruan në kujtimet e veta: "Kushuriri im qeshte dhe bënte shaka me mua duke më thënë se habitej gjithmonë se sa shumë shpirt primitiv shqiptar ruaja unë nën lëkurë aq të kultivuar evropiane." Kozmopoliti Karli boton në blogun personal një histori anonime të masakrimit të çamëve nga Napoleon Zerva. Kërcënohet me vrasje, linçime në parlament, thirrje nga neofashistët për dëbim të shqiptarëve. E lë Greqinë i përzënë, sepse kishte cënuar "tabutë kombëtare". Në këtë rast, ai shfaqet më patriot nga i vëllai provincial. Në dy shembujt e dhënë, provo të gjesh se cili është i natyrshmi dhe cili i natyralizuar?

Më ndodh shpesh të përshëndetem me babanë e Gazmendit, Zaken, i cili u tregua i gatshëm të më sillte dy romanet e të birit, për t'i lexuar, ngaqë kopjet e para në librari ishin shitur. Përherë uroj, që librat të më pëlqejnë, sepse, vetëm kështu: mund të lavdërosh pa gënijer, sikurse e thotë Salman Ruzhdie. Zakoni i të lavdëruarit duke gënijer, kush me furçë e kush me pompë, qoftë dhe lajka facebook-u, e ka mbushur tempullin e letërsisë me statuja prej dylli, ku ndotja e atmosferës letrare prej hipokrizisë është përtej normave të lejuara. "Karli e shpërdoron mënjorinë e tij në iluzione"-thoshte babai i Karlit, i cili u predikoi fëmijëve idealet e Marksit dhe të Engëlsit.

Meqë ishin dy romane, respektova moshën e librave: në fillim "Ditar i shkurtër kufijsh" dhe më pas "I keqi i vetes". Moshë e librave ecën në të kundërtën e autorëve. Libri më i ri përkon me moshën më të rritur. Tek mediokrit ky proces nuk funksionon, ngaqë nuk regjistrohet rritja. Shkurret sado që të shtohen,

nuk u ndrit fati i pemës. Për shkak të ngjashmërisë tematike dhe të rrëfimitarit, nga libri i parë tek i dyti: kemi të njëjtën lëndë, por jo të njëjtin produkt. "Librat e mi nuk janë autobiografikë, por pa dyshim kanë të bëjnë me disa nga fantazmat apo obsesionet, apo pyetjet torturuese që unë strehoj brenda vetes sime."-shprehet autori në një promovim, duke na paraprirë, që, dëshimimtar i ngjarjeve nuk duhet identifikuar, si protagonist i unit të autorit. Por, a duhet ta marrim të mirëqenë, kur personazhi i tij kryesor është i gjithi, sikurse ai pohon për veten e tij: "Unë nuk jam shumë patriot, në kuptimin ballkanik të fjalës. Mendoj se jam më shumë ballkanas apo kozmopolit." I tillë është dhe personazhi i tij, Karli, që vuan nga sidroma e kufijve. Por, pyetjet torturuese, që strehohen brenda autorit, a marrin përgjigje? Hygoi thotë se miti i Sizifit: nuk është gjë tjetër veçse grindja e njeriut me veten. Nuk pashë që personazhet e tij të kenë dilema brenda vetes, secili është i qartë në çka përfaqëson, por "pyetjet torturuese mbeten" më së shumti tek lexuesi se sa tek autori. Kombi, shoqëria, familja kanë më shumë dilema nga individ i quajtur Karli, i cili, sa më shumë kufijë kapërcen, aq më shumë mbyllet në vetvete, i çliruar nga detyrimet ndaj familjes, shoqërisë dhe kombit. Gjithsesi, Karli nuk bie në nivelin "O Mete për vete", pavarësisht se bën shumëçka për t'u ngritur nga hiçi. Ndoshta këtu është e gjithë dilema e tij: të bëhet njësh duke zerosur të shkuarën, e cila depërton tek ai me fuqinë e zakonit. Kufijtë e shteteve kapërcehen lehtësisht, ndërsa kufizimet brenda vetes, duket sikur e rrisin lartësinë e mureve, qoftë dhe midis dy vëllezërve. E panjohura ka uri për të gëlltitur sfidantin e radhës, i cili arrin të kthehet në një aset. Por për kë? I vëllai, Frederiku, mjek në morgun e qytetit, ka një merak: mos i vëllai vret vetën, sikurse kishte ndodhur me nënë e tyre.

Karlit dhe Frederiku, nuk u bënë marksist, sikurse qe përpjekur i jati i tyre, profesor i marksizmit. Emrat e klasikëve për ta: kanë vlerën e një tatuazhi, sikurse portreti i Mao Ce Donit i vizatuar në krahun e boksierit amerikan, Mike Tyson. Edhe profesori i marksizmit, shfaqet më së shumti si leninist dhe, si adhurues i një fuqie absolute, pas përmbysjes së regjimit: islamizohet duke ndërruar klasikët me profetin. Gjithsesi, vëllezërit akuzojnë njëri-tjetrin për ngjashmëri ndaj babait. "Karli e gjen kuptimin e jetës tek ngjyra e zezë. Kështu që ai ngjan me tim atë më shumë se unë. Se edhe im atë besonte se do ta ndryshonte botën. Por bota e ndryshoi atë. Kështu ka për të ndodhur dhe me Karlin." Ndryshimet e Karlit shkojnë drejt tjetërsimit, thuajse i fiksuar t'i shpëtojë racës prej nga vjen. Ndërkohë, e dashura greke, Ana, dhjetë vjet më e re nga Karli, nuk e fsheh gëzimin e sulmit terrorist mbi kullat binjake me motivin: "Sa njerëz të pafajshëm kanë vrarë dhe vrasin amerikanët." E denjë për të qenë vajza e profesorit të marksizmit, tashmë i islamizuar. Si ndodhin këto përkime, të të ngjajë një vajzë bote dhe ai që i ke bërë kokën, ta çon dëm edukimin? Sepse shqiptarët refuzuan të

natyralizoheshin kundrejt një ideologjie, të cilën e braktisën të parët, ata që e predikuan. Kjo artificë ia shumëfishoi vlerën pozimit, kundrejt aktit të kryer. Kurimi i imazhit u kthye në industri kibernetike.

Dallimi midis dy romaneve është i një difference të tillë, si të krahasosh një gurëgdhendës me një skulptor. "I keqi i vetes" nuk ngrihet, si një kat mbi të parin, por e zhyt romanin paraardhës "Ditar i shkurtër kufijsh" në një bodrum të tijin. Kjo që po them, mund të duket si një e keqe, në fakt, të hash nga vetja për hir të kualitetit, në letërsi: merret për mirë. Meqë publicisti ia lë vendin romancierit, valixhia e kurbetliut "kutisë së zezë" së avionit, fatmirësisht tejkalimi i vetes bën që: hapi të kthehet në hop. Kush nuk do t'ia uronte vetes këtë kapërcim? Nuk jam duke folur me plus minuse, kjo bën dhe ajo s'bën, por duke pranuar suksesin atje ku ai shfaqet i plotë, aty ku autori ridimensionohet si shkrimtar i dorës së parë, duke më lejuar: ta lavdëroj pa gënijer. Nëse ti vjen rrotull si kali në lëmë, nuk mund ta pretendosh kalorsin. Mund të rrëfesh sa të duash peripeçira dhe, nëse mua më shfaqet Odiseja, kënaqësitë që të jep arti, i kam marrë tek Homeri, kështu që keqardhje për vuajtjen, por më ke borxh mërzinë.

Aventurat e Odisesë mbahen gjallë nga një ndjenjë e madhe, ai i rikthimit në Itakë, që përkon me dashurinë për vendlindjen, atdheun, ndjenjë kjo që Karlit, sa vjen dhe i zbehet, por që shfaqet si kompesim tek i vëllai, me doza të shtuara provincializmi. Fëmijët e një babai ekstremist, nuk mund t'i shpëtonin skajimit të vetes. Ata humbasin natyrshmërinë duke u natyralizuar, ngaqë përshtatshmëria është vetia që u ka duk më shumë, si banorë të denjë të qytetit: Tersit. "Nga sindroma e kufijve nuk vuajnë ata që nuk u përvëlun kurrë nga dëshira për të kaluar kufijtë apo nuk janë ndier të refuzuar nga ndonjë kufi, do ta kenë të vështira të na kuptojnë."-shprehet autori në vend të Karlit, e cila shkon e gjitha si kundërvënie ndaj vëllait, Frederikut. Ai nuk bëhet më i mirë duke ikur. Kufijtë janë shkaku që vëllezërit me kalimin e viteve, bëhen të huaj mes tyre, duke ngritur një mur mes vedi. E ç'u kuptua, që ra muri i Berlinit?

Përkundër Odisesë, që rikthehet në Itakë, kemi dhe Enean e Virgjilit, që vihet në kërkim të një atdheu të ri, fill pas rrënimit të Trojës. Përherë ndodh një gjë, kur merren rrugët e kurbetit. Ata që e kuptojnë më mirë këtë janë arberëshët. Ndryshe, kur ta shkakton i huaji dhe, ndryshe, kur ia shkakton vetes. Nëse i referohemi epokës antike, me fise që dynden, me aventurierë dhe piratë, Enea i përgjigjet së vërtetës më shumë nga Odiseja, por ky i fundit adhurohet, ngaqë shenjtëroi atdheun. "Por ne të huaj s'jemi. Se shtatë breza një pas një kemi qenë amerikanë, dhe më thellë akoma, irlandezë, skocezë, anglezë, gjermanë."-shkruan nobelisti Xhon Stajnbek ne romanin "Vilet e zemërimit" i përkthyer nga Petro Zheji, i botuar në 20 000 kopje. Raportet e Eneas me Odisenë janë në miniaturë, si ato të Karlit me të Frederikut, si refleks dhe i aktualitetit tonë: për shqiptarë që duan të ikin

dhe ata, që besojnë se ky vend bëhet. Çifutët i lanë pa atdhe, duke i detyruar të provojnë të gjithë si komb fatin e Eneas në kërkim të atdheut të humbur, por, erdhi dita që, hebrenjtë, të përngjanin me Odisenë dhe të riktheheshin në Izrael. Kujtoni fjalët që u drejtohen kozmanautëve, kur futën në orbitën e tokës: “Mirëseerdhët në shtëpinë tonë!” Dhe një meteor kur bie në tokë, një masë shkëmbore e hekurt, përkundër mijëra të tjerëve që shuhën në hapsirë, të ngjallë habi vetëm e vetëm se lënda e tij përngjason me lëndën tokësore, duke u kthyer: nga imazh në fakt konkret. Sepse e huaja, sado e largët qoftë, vlerën ia masim me të qenit si ne. Kështu që kozmopoliti nëse do t’u ngjajë vetëm atyre, duke u larguar prej të vetëve, do humbas natyrshmërinë, duke u natyralizuar.

Sipas Aristidh Kolës: fjala “pellazg” vjen nga “Pelargë”, që do të thotë “lejlek”, zog shtegtarë, i cili ka përveti kryesore: emigrimin dhe kthimin në atdhe. (Për shqiptarët ngjarje është kthimi i Skënderbeut në Krujë dhe jo ikja e Moisi Golemit.) Rilindasit të malluar për atdheun i kushtuan shumë poezi “shpendit udhëtar”. Tani avionëve po u vënë emrat e poetëve. Gjithë jetën shqiptari ka qenë ikanak, mercenar, nizam, refugjatë, por atdheu mbijetoi, jo prej të ikurve, por, falë atyre që rezistuan, qoftë ky një Vrana Konti në kështjellën e rrethuar të Krujës apo Oso Kuka i mbyllur në kullë. Izolimi komunist nuk ishte rezistencë, ai ishte një ngujim, ku kalimi i kufirit paguhej me jetë, por kostoja më e madhe do ishte degradimi i vendit. Kështu që as Karli dhe as Fredriku nuk vlejnë si model.

Duke kapërcyer kufijë, Karli ndërton raporte të reja me botën, por nuk i vidhet dot vetes, mjedisit prej nga vjen. “Unë mundohem t’i marrë me të mirë (kufijtë), t’i bind se nuk rrezikojnë prej meje, po ata sajajnë ndonjë pretext për të më përzënë ose për t’iu shmangur një marrëdhënie të pabarabartë me mua.” Dhe për pasojë vjen dëshpërimi i të atit, i cili kishte këmbëngulur që i biri të bëhej poliglote: “Nuk u lodhe, Karl, që e kalove jetën duke folur gjithë gjuhët e të tjerëve?” Karli iku që të ndëshkonte babanë tonë, dëshmon vëllai tjetër, duke u ankuar se vëllai ka ngritur një mur, materiali i parë me të cilin është ndërtuar është nënvleftësimi për të vëllanë, duke e quajtur provincial.

“Tiranovskaja biblioteka” ishte një lojë fjalësh nga rusishtja, ku pofesori i marksizmit, i cili kishte studjuar në Moskë, shpresonte të indoktrinonte djemtë e tij, por plangprishësi do quhej Karli, i cili do ia kursente të atit edhe lotin. “Do të vras, nëse tallesh.”-i qe hakërruar ai të birit, i dalëduarësh. Luksin për t’u tallur me etrit e kishin veçse pinjollët e Bllokut. Helena Kadare në librin e saj “Kohë e pamjaftueshme shkruan: “Is (Ismail Kadare) nuk i kishte duruar dot kurrë ato që i quante “poza intelektuale”, të fëmijëve të nomenklaturës. Të sigurt se *ishin të mbrojtur nga baballarët* (ndonëse jo aq sa ç’kujtonin ata), disa prej tyre i lejonin vetes luksin e të bërit humor me gjëra që të tjerët nuk do të guxonin. Kjo pinte ujë, sepse bënte efekt dhe shumë njerëz i mahniste. Is më kishte shpjeguar se të tillë në perëndim kishin një emërtim: quheshin “majtist luksi” ose të “havjarit”.

Nëse babai i Karlit nuk jetonte pa një fuqi madhore, Karli do ndjehej i çliruar teksa shihte rrëzimin e shtatores së diktatorit. Ishte koha kur kishte më shumë gjëra që vdisnin, se të tilla, që lindnin. I ndodhur mes turmës që e tërhiqte zvarr shtatoren duke e përgërrur, Karli, përngjan më shumë me ata që e merr turma, se sa pjesë aktive e rebeluesëve. “Procesi i copëtimit të shtatores me frikën se mos ringjallej kufoma. Karli nuk i shkoj ndërmend të merrte si suvenir ndonjë copë nga kufoma e shqyer.” Ky copëtim i shtatores përjetohet, si një shfaqje groteske, nëse krahasohet me zhvarrimin e Skënderbeut nga ushtarët turq, të cilët i përdornin kockat për hajmali. Karli u çudit kur pa se jo pak prej liderëve të protestës ishin fëmijë të përkëdhelur të regjimit, që befasisht kishin zbuluar magjinë e rebelimit kundër etërve. Mesa duket ata nuk i mundonte asnjë lloj ndjenje faji apo turpi për baballarët e tyre. Fundi i fundit ata s’po rebelonin kundër baballarëve të tyre,


por kundër sistemit që po jepte shpirt. Një nga arsytet që Karli vinte rrallë në Ters ishte frika se mos ndeshte në rrugë, Idajetin, mësuesin e muzikës. I arrestuar në shkollën, ku i jati i tij ishte drejtor dhe i detyronte nxënësit ta pështynin, kur mësuesi i muzikës kaloi mes tyre me pranga. E quajti të birin dezertor, frikakak se nuk bëri si të tjerët.

Përkundër personazhit të tij, Karlit, i cili tallej me “Tiranovskaja biblioteka”, si publicist, autorit i ndodh të intervistojë pasuesin e Enver Hoxhës, Ramiz Alinë, në shtëpinë e tij, ku i tërheq vëmendje biblioteka me libra në gjuhën frënge. Nuk ngurron ta pyesë: “A e dini që në epokën, kur ju kishit pushtet absolut mbi Shqiptarët, nëse dikush kapej me një libër të tillë mund t’i shkatërrohej jeta një herë e përgjithmonë? Përse i ndalonit librat?”

“Po ja Gazmend, e bënim për t’ju mbrojtur. Si prindi që duhet të mbrojë fëmijën nga gjërat e rrezikshme”-i përgjigjet ideatori i “Tiranovskaja biblioteka”. Shihni sa interesante është kjo situatë, nëse i referohemi librit të Guen Robyns “Geraldina e shqiptarëve”: “Kurrë mos lexoni Frojdin, Niçen dhe Shopenhaurin apo filozof të tillë! Janë të dëmshëm për ju!”-janë fjalët që prindërit ia këshillojnë Geraldinës. A është atërore përgjigjja e shefit të propagandës? “Do të vras, nëse tallesh.”-të vjen si jehonë hakërrimi i babait të Karlit. Realisht, kundrejt pinjollëve ata u treguan pedantë, ndërsa ndaj të tjerëve: gardian. Sepse në diktaturë të vrisnin duar që brohorasin, dhëmbë që kafshojnë dorën që i ushqen, buzë që përbuzin të vyerin, gjuhë që demaskon krenarin për hir të krekosjes, vështrimet vëngër eprorësh debilë, dhe në gjithë këtë barbari gjymtyrësh, ngrihen apologjira për gjoksin, që i kthehej erës dhe armikut, duke të vlarë pas shpine. “E dua gjoksin tim. Sepse me të nuk mund të vrasësh askënd. Ndërsa duart, këmbët, dhëmbët dhe gjuha, edhe shikimi madje, janë armë, të afta për të vlarë apo dëmtuar.”-shprehet personazhja e romanit “Vegjeteriania” e shkrimtares Han Kang, përkthyer tani në shqip. Ajo refuzon mishin për të hequr mizorinë nga vetja. Një katarsisë pa mëkatuar. Si është e mundur, pikërisht “kanceri i gjirit” shfaqet në këtë paqësi hyjnore? Sepse dhuna nuk ikën bashkë me diktaturën, ku stresi po e shkatërron qënien njerëzore.

Ngjarjet e romanit zhvillohen në një qytet i quajtur “Tersi”, ku duhet nënkuptuar dhe qytet-shteti me emrin Shqipëri. I prishur me tërë botën, ku flitet shumë për ty, por asnjëherë mirë për ty. E dashura e Karlit, Klodi, kishte të njëjtën dashuri si për njerëzit dhe për qytetet. Por, Karli nuk e do qytetin e tij Tersi. (Nolit i kishin ngjitur nofken “Tersi”). “Banorët e këtij qyteti katërcipërisht të panjohur duket sikur zotëronjë një ves tronditës: ata kanë dështuar atje ku shumica në Evropë ia kanë dalë mbanë dhe ia kanë dalë mbanë

atje ku shumica në Evropë kanë dështuar.” Një qytet i përshkruar më shumë pas viteve ‘90-të se sa në kohën e diktaturës, duke mos u bërë më i mirë nga ç’ ishte. “Bosit të Betonit” i bëheshin homazhe në hollin e bashkisë, ndërsa femra që u gjet e vlarë në makinën e tij, e përfolur si lavire: shoqërohej në varreza vetëm me familjarët, ku i bashkohet Karli dhe Pandi i Krisur, sepse qyteti kërcënohej nga banda e bosit. Është po ajo skenë varrimi eurve, sikurse u ndodhte atyre me “njollë në biografi” dikur. Qyteti i Tersit fle si thashethemaxhi dhe zgjohet si poet. “Unë e dua Tersin, Karl,-tha Pandi i Krisur pas pak.-E di pse e dua, Karl? Se nuk i ka bërë kurrë keq askujt. Vetëm vetes.” Karli i pëlqen ky konstatim, por refuzon të jetë banor i Tersit, ngaqë e tërheqin qytete, ku e përzënë. Të qenit i keq ndaj vetes, mund ta përligjim dhe me fatin e Frederikut, në këtë rast është fjala për poetin Reshpa për të cilin Kadare në librin “Mëngjeset në Kafe Rostand”, shkruan: “Ato pyetje ishin të rënda dhe kërkonin përgjigje nga të gjithë: pse u braktis aq çnjerëzisht dhe si u la të vdiste në atë vetmi të frikshme? Ishin vetëm dy shtete që duhet ta mbanin fajin: ai komunist në fillim dhe shteti “kapitalist” më pas, apo faji do të kërkohet gjithkund, më thellë, më gjerë, gati-gati te të gjithë?”- Nuk është njësoj, kur të lënë vetëm dhe kur ti, veçohesh për të bërë dallimin me të tjerët. Dhuntitë nuk deklarohen, ato ushtrohen. “Bota është e vogël dhe ajo nuk mund të pranojë në gjirin e saj një njeri të madh, si Majakovski.”-do shkruaj Llunaçarski ditën kur poeti komunist vret veten. Mos harroni, poeti i përket vendit me sipërfaqe më të madhe në botë dhe ku vetvrasja dënohej. Këto fjalë u thanë për poetin komunist në kohën e diktaturës staliniste. A kemi ne shembuj të tillë adhurimi? Veç Çajupit, “Vdiq Naimi, moj e mjera Shqipëri! Si Naimi s’ka të tjerë!”, nuk kam hasur një rast të dytë. Gjithandë veçse histori denigruese. Nisur nga emrat e personazhëve, Karli, do më kujtonte Karl Topinë: i përzjer ky me gjak francezi për shkak të aventurës së babit të tij me Helenën, e cila ishte nisur të martohej me një grek dhe e rrëmbeu shqiptari, si të përsëritej kështu historia e Trojës. Nuk është problemi të bësh përshtypje, e gjithë çështja është të lësh gjurmë. Në Hënë shkuan dhe të tjerë, mbase vjen një kohë dhe popullohet, por gjurmët e Amstrongut do i mbetën historisë. Një i tillë që lë gjurmë është dhe poeti shkodoran, Reshpa: “Të jesh i braktisur në letërsi, pa dyshim, një fatkeqësi. Po ta dish këtë, të jesh i ndërgjegjshëm për të, është dyfish e tillë. “Më duhet të pranoj se unë kam qenë gjithmonë i braktisur”, ka pohuar ai vetë në vitin 1998. Dhe më pas: “Kam kaluar nga një braktisje te tjetra.” (Kadare “Një prill për Fredin”) Kundrej Karlit, që e bën dallimin duke u veçuar, ai që ka nevojë për vëmendjen tonë është i braktisuri, Frederiku.



IA ÇMONTOVA TRUPIN

ia çmontova tupin
të shikoja ç'kishte ndryshe prej meje
ajo rrinte dhe më kqyrte e habitur
me dy sy kafe të errët në duart e mia
zemra aty i rrihte
e kuqe
si imja
të gjitha të tjerat
si të miat
ku ishte magjia?
ia montova përsëri trupin
duhet t'i çmontoja shpirtin
m'u desh të mësoja gjuhën e hijeve
çmontova hijet
njëlloj si të mijat
ku ishte magjia?
çmontim dhe montim
arrita te dashuria.



E KUSH E MBAJTI FJALËN?

do dal për gjah
të vras mesnatat
bashkë me hënën e plotë të majit
bashkë me detet në zbaticë
që kanë hyrë në një trivargësh haiku
bashkë me vilarët blu të jargavanëve
mbi portat me iniciale
bashkë me urat
plot me dryna të kyçur të dashuruarish
që çelësat i hodhën në lumë
e kush e mbajti fjalën?
do dal për gjah
me një pushkë të gjatë në krah
të vras mesnatat
ëndrrat me porta të hapura
se vjen ajo sërish
pas infarktut të tretë
më bën me infarkt të katërt
do vras mesnatat
më parë do shkoj nga urat
të hap drynat
me një çelës kopil
të dashuruarit të dashurojnë përsëri



KAM MBETUR VETËM FILLIKAT

kam mbetur vetëm fillikat
më vetëm se vetëm
as mish, as skelet
shpirtin e harxhova në letër
s'jam as erë, as ajër, as pemë
ndoshta fjalë e humbur në hapësirë
po sytë i kam, vetëm sytë
dhe shoh një kometë që zbret
bishtin e gjatë e mbaj unë
është një kometë veshur nuse
zbret prej blusë të shkojë në blunë e deteve
dhe unë jam një shoqërues
zbresim e zbresim, tani s'jam vetëm
dhe kam një ndjesi prej dashnori hajdut
zë dhe i bëj korte si një parvenu
ende pa ia parë fytyrën dhe hiret pa ia parë
urra! s'jam vetëm, paçka se fjalë kam mbetur
as mish, as skelet, po as shpirt, vetëm sy
por ndiej sikur të isha trup
të dua, të dua, i them, të dua, kometë
dhe si një hajdut e vjedh
me kometën jam martuar,
fjala e humbur në hapësirë
lind kometa të tjera blu



LIRIKA
nga Roland Gjoza



KUSH THA SE KAM DY SY

kush tha se kam dy sy
dy buzë
dy duar
kush tha
m'i ke marrë ti, moj e shkalluar
kam mbetur
me një sy
me një buzë
me një dorë
dukem si gjysmagjeli i përrallës
s'të vjen keq për mua?
prej budallallëqeve e kam
prej poezive të dështuara që të kanë rënë në kokë
dhe peng m'i mban
po me çfarë të puth
me çfarë të shkruaj
ca kacurrela që kisha si kam
dhe e blerta e syve më është tharë
dora ka zënë të dridhet
s'ka ku mbahet
më paske marrë dhe gjysmën e zemrës, moj e
shkarë
ca brinjë bosh
që therin
po vjen dimri me ngrica
dhe do të më përcjellin
dhe në qofsha atje në shish tufinë
eja
më jep ato që më ke marrë
ndoshta ngjallet
jo për vete
po për ty
bëjmë dashuri
një i vdekur
me një të gjallë
ku i dihet
ndoshta dal
bëjmë shëtitje në bulevard
po ti do të kesh tre sy
tre buzë
tre duar
si hidra
dhe me njëmijë të lutura s'do të m'i japësh të miat
kjo shëtitje e fundit më është shkruar
unë si ciklopi
nëpër tiranë
dhe ti si hidra
do të trembim shokët
moj e shkalluar

S'E KAM FAJIN UNË

ti më ndjen kur të vijë tinëz
dhe të shtyp në brinjë
s'e kam fajin unë
dy oqeane na ndajnë
dhe po ai qiell është për të dy
prandaj ndodh kjo mrekulli
jo prej largësisë
po prej shpirtit
asgjë s'do të ndodhë sigurisht
edhe në qoftë se t'i prek gjinjtë
dhe nga gjumi të zgjoj
s'e kam fajin unë
janë ndjenjat që luajnë
edhe në qoftë se ti drithëron
dhe pëshpërit; mos, mos..
gishtërinjtë e mi të gjatë të shkasin nëpër kofshë
pastaj atje
atje
afrohen e të ngacmojnë
me ngulm prej të çmenduri
s'e kam fajin unë
edhe në qoftë se ti trallisesh në një orgazmë pa fund
një lëng veshtullor
ngjitës
të kullon poshtë dhe të tërbon
më ndjen me llahtarë si të depërtoj
s'e kam fajin unë
mos më mallko
për netët pa gjumë
për mëkatën pa gjurmë
më kap po munde
thirr policinë
po edhe ti e di
s'e kam fajin unë



PUTHJA

elektrike është puthja, prej saj
me dritë u mbush trupi
s'ndodh nga vërshimi i lumenjve
mbi diga
mjaftojnë dy buzë që bashkohen

e kopjoi edisoni!

s'është llamba e tij që ndriçon netve
s'vjen prej hidrocentraleve, centraleve atomikë
drita
po prej puthjeve

mos e shuani!

DHE UNË BIE NË DASHURI

31 tetor 2014, halluin
dhe unë bie në dashuri
me të gjithë të vdekurit që kanë mbushur Nju Jorkun
të gjallët kanë ikur
të vdekurit varret braktisin
një herë në vit kjo ndodh
në tetor
kur ata ringjallen
dhe unë dal me një maskë të Edgar Allan Po
jo për festën
po për Euridikën time që e kërkoj nëpër avenjutë dhe
stritet
sonte të gjitha femrat janë euridike
dhe të gjithë meshkujt orfe
vetem unë edgar allan po-e
jo, s'më kishte vajtur ndërmend se në broduej
do të shihja një vajzë me flokë të verdhë ku binte
dëborë me pllaze të mëdhenj
me sy blu ku dyndej errësira me njëmijë hëna
që mbante në duar detet e veriut në kohën e agimit
boreal
ajo vinte drejt meje e hareshme dhe thërriste; jam
annabel lee
eja me mua në rrafshnaltën me dëborë
poshtë është oqeani blu dhe kasollja jonë me rrota
eja ta shtyjme dhe të shkojmë përgjithmonë
kërkoja euridikën e deteve të mesdheut dhe gjeta
annabel lee
në detet e veriut ku dashuria kishte rrota
dhe nata kishte rrota
me rrota dhe kasollja
shkuam përgjithmonë dhe ishte 31 tetor
2014



Ç'JANË KËTO FLAKË NË DËBORË

ç'janë këto flakë në dëborë
që e djegin
e bëjnë shkrumb
flakë që pështillen si lianë në mishin tënd të bardhë si
kristal
e bëjnë më të ri
e bëjnë më të bukur
në mishin tim flakërojnë me njëmijë brirë djajsh
bën diell me flakë
bën vjeshtë me brinjë të shqyera
nga një dorë barbare
nga një dorë ledhatare
nga një dorë sensuale
me zemrat përjashta që pikojnë gjak
jo vetëm një brinjë
po të gjitha brinjët u bënë eva
se kështu vjen pranvera
me femra prej poleni në ajër
që i bëjnë meshkujt të lulëzojnë
me aroma që ende s'ekzistojnë
me ngjyra që ende s'i njohim
dhe kaq fort kundërmojnë
sa të gjithë parfumet
e l'acoste dhe kristian dor
dhe i këputin me dhëmbë
dhe iu marrin erë me zemër
dhe iu copëtojnë shpirtin me përkëdhelje
dhe mishin ua shqyejnë si hijena
femrat
të gjitha janë eva
s'ka më adamë
do të shkruhet bibla e re
zoti s'do të thotë të bëhet dritë
po të bëhet femër!

ASGJË NUK NDODHI ME NE

asgjë nuk ndodhi me ne
asgjë e rëndësishme
veç trëndafilat këputëm
dhe iu morëm erë
u lagëm në shi
dhe me topa bore luajtëm
pastaj unë te kushtova një poezi të vogël
që ti e mbajte në kutinë e bizhuve
ku kishe vetëm një gjerdan me gurë të rremtë
dhe asgjë më
ç'të kujtoj tjetër?
prandaj e pritëm të qetë humbjen e rinisë
dhe kthimin e fletës së fundit të biblës sonë
apokalipsin e moshës që mori hijen e ciklonit
ah, harrova
dhe një tjetër poezi të vogël të kushtova
për bukurinë që s'të humbi pothuajse
ndonëse mori rrudha
dhe flokun e thinjur ta leu me platin
dhe buzët me të kuq
bashkë
gati gjashtëdhjetë vjet pa u penduar
pa bërë faje të rënda
tani rrimë përballë njëri-tjetrit si dy perëndime të shuar
se fjalët na kanë shkuar si shtergë madhështorë
në vendet e ngrohta të kujtimeve
ç'ka mbetur tjetër?
sa herë ke ditëlindjen unë harroj të dhuroj një buqetë
me margarita
ti nuk harron kurrë
të më japësh një të puthur
prej ndjenjës prap lot të nxjerr syri
dhe një sekret të fundit
ju lutem, mos ia thoni
unë jam si një zjarr në rrafshinën me dëborë të vjetër
ajo ende më thotë të dua



MOS I HIQ TË GJITHA

mos i hiq të gjitha
të gjitha mos i hiq, lëre mbrëmjen përjashta të bjerë
dhe hënën të kalojë midis kofshëve të gjata
dhe mos e hiq oqeanin që largohet
as manhattanin që duket si një kupë me lapsa
eja me gjithë reklama
se ty të shkon shkëlqimi
të gjitha mos i hiq
eja dhe bjer mbi mua
me gjithë botën përjashta
të bëjmë dashuri universale
në një shtrat kozmik



PO DAL, THASHË

po dal, thashë
jashtë vetëm zogj kishte
dhe drurë
pastaj dolën ketrat në lirishtë
dhe xixëllonjat kandileve iu këputën flakët e akullta
dhe i tundën për të verbërit në errësirë
sa kohë kishte shkuar pa menduar për ty
ku e paskam patur mendjen?
një flutur e madhe tund brirthët e gjatë dhe lëviz
krahët sikur fërkon yjet
dhe kalamendet
si e dehur me verë
e ndjek si një parandjenjë
si një flirt që shkoi
të kisha harruar për një kohë kur u mora me shkrime
po ja, prap m'u kujtove
sa herë jam vetëm
dhe xixëllonjat flakë akulli këpusin prej kandileve
dhe ketrat vrapojnë me shpejtësinë e hijeve
kur i ndriçojnë dritat e makinave
pse m'u kujtove sonte?
diçka ka ndodhur se dhe era vjen prej larg si soprano
suvalë e oqeanit brigje të largët mbulon me sajnë dhe
shkumë
dhe retë dynden prej pafundesisë me një aromë shiu që
ende është frut
ndoshta dhe ti mendon për mua
po s'të dhemb as kujtimi
jam mashkull
një brinjë ma kanë shkukur
dhimbje ndiej më shumë
kush u dashurua dhe nuk u trishtua në fund?
rri dhe mendoj për ty
sikur kjo është kinemaja
sikur kjo është opera
edhe po të mos vish
edhe po të mos shoh më kurrë
rri dhe mendoj për ty



KRIPËN S'E KANË DETET

kripën s'e kanë detet
kripën e ka gruaja
pse i këndoi euridikës orfeu
dhe petrarka laurës
dante beates?
kripën e ka gruaja
ajo është deti i lakmuar
pse nuk i këndoi euridika orfeut
laura petrarkës
beate dantes?
burrat janë barka
shkojnë nga deti në det të shijojnë kripën e bekuar
shkojnë larg
detet rrinë në vend
e ka kot verdi me dona mobile
dhe kur brigjet braktisen varg e vistër
fajin e kanë barkat
që lakmojnë kripën
pse nuk i këndoi euridika orfeut
laura petrarkës
beate dantes?
sepse s'ishin barka, po dete
a ka ndodhur ndonjëherë që të këndojë deti për poetin?
kripën e ka gruaja
kjo është çështje e ndërlikuar
kështu thotë dhe shekspiri

Erotika e Janis Ricos

Eleana Zhako - përkthyesë

*Amor Vincit Omnia**
[*Dashuria pushton gjithkënd]
Virgjili


Një poet në fillim të të shtatëdhjetave, me një profil të skalitur nga një skulptor i panjohur i Greqisë së lashtë, me një mjekër gjysmë të hirtë, që ia thekson më tepër konturet e fytyrës së tij paksa të gjatë, me një cigare të përhershme në gishtërinjtë e tij, dhe që pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi bindjeve komuniste dhe poezisë, ka një emër të njohur tashmë në gjithë botën: Janis Ricos.

Janis Ricos (1909 – 1990), nuk është aspak i panjohur për lexuesin shqiptar. Një pjesë e madhe e veprave të tij poetike, janë sjellë në gjuhën shqipe gjatë një periudhe të rëndësishme kohore, gati pa ndërprerje, me pikënisje librin “Mëhallat e botës”, përkthyer nga Spiro Çomora, më 1961. Ajo çka e bën të dashur poezinë e Ricosit për përkthyesit shqiptarë, është fqinjësia me Greqinë, fryma e majtë e poezive, larmia e tematikave të tij, lirizmi mallëngjyes dhe bashkërenditja krahas poetëve më të njohur botërorë. Ricosi është ndër poetët grekë më të përkthyer dhe bashkë më dy nobelistët grekë, Odhiseas Elitis dhe Jorgos Seferis, përbën poetin e tretë grek, i cili ishte në prag të Nobelit, por që për shkak të frymës së theksuar politike të poezisë së tij,

mbetet “nobelisti i panominuar”. Por, porsi poetët, Pablo Neruda (1953), Bertolt Brecht (1954), Luis Aragon (1957), Kostas Varnalis (1959) dhe piktori Pablo Pikaso (1962), Ricosi, do marrë në vitin 1977, “Çmimin Ndërkombëtar të Paqes Lenin”, i cili ishte çmimi më madhor i Bashkimit Sovietik dhe ekuivalenti i Nobelit.

Në vëllimin poetik, që i prezantohet lexuesit shqiptar, nga Shtëpia Botuese “Dituria”, me titullin “Erotika”, poezia e tij i largohet frymës së theksuar politike, që karakterizon krijimtarinë e tij të viteve më të hershme, dhe i kushtohet Erosit, Imerodit, dashurisë mishtore, mallit për të dashurën, *gjumit dashuror pas dashurisë*. Në fund të të gjashtëdhjetave të tij, gati dhjetë vite para vdekjes së tij, Ricosi do i falet Erosit me përdëllimin e një besimtari të përbetuar. Kërkon të sfidojë nocionin e kohës, këtij Polifemi gllabëritës, përmes verbimit të tij me shigjetën e dashurisë. Dashuria për poetin nuk ndalet as në gjumë. Porsi lumi, ajo rrjedh vazhdimisht dhe merr me vete gjithë pemët e gjithë zogjtë.

Gjumë dashuror pas dashurisë. çarçafë të djersitur që varen nga shtrati përtokë. Dëgjoj nëpër gjumë luminefortë. Rrjedh ngadalë. Trungjet mëdhapemësh rrëshqasin në të. Në degët e tyre një mijë zogj udhëtojnë pa lëvizur me një këngë të zgjatur uji e gjethesh, që ndërpritet nga yjet. [...]



Erotika, përbëhet nga tre pjesë, të cilat pavarësisht ngjashmërisë, dallojnë nga njëra – tjetra për nga stili, vargu dhe veçanësia. Pjesa e parë, e cila titullohet “Suitë minore në të kuqe maxhore”, përmban 44 poezi të shkurtra, të cilat nuk janë të ndara në strofa dhe vihet re mungesa e shenjave të pikësimit. Poezia për Ricosin është një akt i pafundmë dashuror, ku fjalët përflaken, porsi lëkura e burrit dhe e gruas kur bëjnë dashuri, është kazma dhe lopata mbi mermer, kokrriza e rërës ngjitur në trupin e të dashurës, qiell i kuq i mpiksur, filxhani i porcelantë ku pasqyrohet lakuriqësia e saj, rrënjë të kapërthyer, gjithë universi, i mbujtur me spermë, bajgë e lule limonësh.


Pjesa e dytë “Trup lakuriq”, është një poemë erotike vargjeshe të shkurtra, ku poeti mbyllet në trupin e të dashurës, fle e zgjohet brenda saj, në qendër të vargut ndodhet vetëm ajo dhe krejt natyra, trëndafili që lartësohet i vetmuar, ylberi, pylli i praruar, druvarët, zogjtë, deti i Monemvasias, vendlindjes së poetit, fiqtë e egër mishtorë, figura të lashta mitologjike, Odiseja, Penelopa, Imerodi, ngjizim imazhin e muzës së tij, që ndodhet larg.

*Dy muaj që s'u pamë.
Një shekull
e nëntë sekonda*

Ndërsa, pjesa e tretë, “Fjalë mishtore”, janë poezi që ngjasojnë më tepër me proza të vogla poetike, për nga struktura e vargjeve. E dashura e poetit është një Diotimë mishtore, e kundërta e Diotimës platonike të lashtësisë, e cila përmbledh në trupin e saj gjithë trupat, që ai preku, vështroi, mori, ëndërroi; është një prostitutë – rioshe, që priset, pa çarë kryet për paratë e klientëve mbi komodinë; një vajzë, që qëndron poshtë lulemollëve dhe petalet futen mes gjinjve të saj; një vajzë me përparëse të bardhë, që mbledh të vrrarët e zhveshur.

*-Mishra të çarë, gjak-
nuk është gjaku i 27 ditëve të tua; por edhe ai
më zbramps, më pengon, më tundon. Gjaku
është bërë që të rrjedhë shpengueshëm nëpër vena; që ta
dëgjosh përgjatë natës
zemërmezemër, si muzika që vjen poshtë dyshemesësonë,
ku një tjetër çift
me muzikë po përgatit më thellë dashurinë e tij.*

Erotika, është kuintesenca e krijimtarisë erotike më të rëndësishme të shkrimtarit, është graham e tij e fundit për t'u përballur me vdekjen.



François Cheval: Himn spartan



A duhet që të gjithë në një farë pike, të ndiejmë nostalgji apo keqardhje për prejardhjen tonë? A duhet të kthehemi pafundësisht mbrapa, në hapat që bëjmë? Pse duhet ta pyesim veten pambarimisht mbi këto çështje përkatësie? Për të ditur se kush jemi? Aspak! Vetëm për të ecur përpara e për të mos e menduar më. Shtatë fotografë shqiptarë gjenden në Shkodër, në kryeqytetin e dikurshëm të Shqipërisë, të ftuar nga Art House dhe Muzeu Marubi për të evokuar disa imazhe të thjeshta e të thella që i frymëzojnë. Emigrimi, ky ekzil i paemërt, është pjesë e rrugëtimit të secilit. Nuk e dimë akoma çfarë i mban kaq të lidhur: shpirti i vendit, dashuria për vendlindjen, ndërgjegjja e qartë e një ripërtëritjeje kombëtare... Pak por e sigurt, shkrimet e tyre, ndonëse të largët nga njëri tjetri, do të rrinë përbri në forma ende të papërcaktuara.

Momentalisht, as ata vetë nuk e dinë nëse duhet ta braktisin apo ta përvetësojnë atë që i motivon.

Duke hedhur një vështrim nga e kaluara, punët e tyre herë lidhen me të moshuarit që vazhdojnë të jetojnë në vendin e lindjes e herë të tjera shkojnë akoma më larg, në kohën e paraardhësve apo themeluesve. Peizazhin ata nuk e analizojnë, e sodisin. Sa i afërt po aq i largët, nuk arrijnë të kuptojnë çka t'i heqin e çka t'i ruajnë. Në disa udhëtime të bëra në pak kohë, e parandejnë që kthimi në vendlindje shoqërohet nga një mjegull e dendur, por që nuk është kurrë shumë vonë. Ata kuptojnë praninë e diçkaje që u duket e panjohur dhe e pakapërcyeshme, intensiteti i së cilës, që nga peizazhi e deri tek banorët, mundet t'i mohojë. Në pamjet e Romës, Milanos, Firences, Berlinit apo Laipcigut, në fund të atyre gjërave të perceptuara për një kohë të shkurtër, qëndrojnë disa objekte kuptimi i të cilëve duket sikur ka humbur: figura

të vagullta, peizazhe të shkreta, vizione e trajta të shpërfytyruara nga absurditeti i një historie të ditëve tona. Duket qartazi që aspirojnë për të konfiguruar një horizont më të gjerë. Në sytë e tyre, bota e vjetër, Shqipëria, shihet si diçka e re që i reziston objektivit fotografik e do t'u ikte përfundimisht, nëse nuk do të përpiqeshin të dallonin disa forma «të vërteta». Për të ndërtuar një marrëdhënie me këtë vend dhe banorët e tij, është i domosdoshëm ballafaqimi. Këndi i fotografimit përmbledh disa vizione që duan të jenë gjithnjë e më largpamëse. Na merret fryma për një çast! Por nëse arsyeja vuan tek dëshiron të bëjë të qartë realitetin me të cilin ballafaqohen, ata besojnë në një fotografi që lajmëron të nesërme të reja, një akt vullnetar të ndërgjegjes që ringjall disa imazhe të varrosura në kujtesë.

Dëshira për qartësi ndriçon disa punime që luftojnë kundër hijeve. Me një aparat fotografik, duhet pranuar e pakuptueshmja dhe duruar e padurueshmja. Ajo që këta fotografë nuk arrijnë të kuptojnë është fryti i errësirës që i karakterizon, një poetikë instinktive e irracionale, ndonjëherë naive, e cila pranon dhe refuzon nostalgjinë. Koha përzihet me kontradiktat e hezitimet. Fotografia, edhe kur nuk kontribuon për të ndryshuar ekzistencën, është premtimi i një ekzistence të re sepse në vend që të japë zgjidhje, ajo i ofron kthjellësi e ngushëllim një njeriu të trishtë. Shtatë fotografët jo pa qëllim kanë marrë rrugët e Ballkanit, duke bërë bashkë copëzat e mozaikut, duke zgjedhur rrugën e vetme të mundshme, atë të ndjesive dhe subjektivitetit. Ky ritakim me tokën e origjinës mbart në vetvete përgjegjësi të reja. Ata ende nuk janë të aftë ta rrëfejnë këtë ndjenjë të turbullt, gjënë e pathanë që ata e dëshirojnë me gjithë shpirt, ndjekjen e pamundur të një bashkimi të humbur. Sepse nëse

kombet nuk janë të pavdekshëm, shpirti i një populli mund të jetë. Ndonëse të varur nga e kaluara, janë ata vetë që duhet ta rindërtojnë, ta përjetësojnë e ta transformojnë. Vetëm përmes një qëndrimi kritik, ajo do të mund të marrë jetë. Akti fotografik, mes vullnetit dhe urgjencës, e ka të nevojshme harresën. Si faktor i rëndësishëm i një mendimi të qetë, duhet të dimë t'i lemë gjërat pas. Ndonëse fotografët nuk mund të parashikojnë të ardhmen, ata kanë një fuqi të çuditshme, atë të rrëfimit të historive me pak elementë: copëza imazhesh të ndryshme, përzierje kujtimesh, fragmente arkivash, huazime të ndryshme e shkrepje.

Janë toka dhe banorët e saj që i japin fotografëve thelbin, shpirtin, mosbesimin, atë që Ernest Renan quan «*plebishit i përditshëm*».

Ndërgjegjja në lëvizje reklamon veprimin, fabrikën e imazheve. Ajo mezi pret të pëmbushet. Nuk po flasim këtu për lojën e mashtërimeve që nxitet nga fotografia bashkëkohore dhe e institucionalizuar me anë të një vazhdimësie posturash të ngrira e automatizmash të urryeshëm. Fotografimi duhet t'i përgjigjet një nevojë jetësore. Është pikërisht në ballafaqimin me Historinë dhe historinë e tyre që krijohen veprat e vërteta, në kundërshti me konformizmin e përgjithshëm e kundër uniformitetit të estetikës. Fotografitë e rrënjësura thellë në pikëpyetjet e dyshimet e tyre janë fusha më e bukur e zbulimit e propozuar ndonjëherë. Një moment i privilegjuar, i gdhendur në gurin e ashpër të reales, përherë kompleks e mbi të gjitha i padeshifrueshëm. Ky kërkim nuk është i pashpresë dhe fisnikëria e tij nuk qëndron tek akti, por tek ajo që pretendon të arrijë.

Përkthyer në shqip nga Tea Çuni



• Botohet në Serbi përmbledhja “Shiu i fytirës time” i shkrimtarit Visar Zhiti, përurohet në
• Panairin e Librit në Beograd dhe vlerësohet me çmim nga shoqata e poetëve dhe përkthyesve
• të Malit të Zi

POEZIA QË GUXON MË SHUMË...

VISAR ZHITI SHKRUAN ASHTU SIÇ JETON

Është poezia që guxon më shumë dhe arrin të bëjë ndonjëherë atë që nuk ia dalin dot ta bëjnë dekadat, diplomacia, politika dhe marrëdhëniet tregtare, sidomos në Ballkan.

Poezia, duke sjellë të bukurën e përbashkët, atë të artit të madh, por dhe një të vërtetë jete, si dhe drejtësi, moral dhe etikë, përbashkon njerëz dhe vende.

Kjo ndodhi me poezinë e Visar Zhitit dhe ku, në kryeqytetin serb, në këto ditë tetori gjatë Panairit Ndërkombëtar të Librit në Beograd, i 64-ti, më i madhi në rajon e më gjerë, ndër më të njohurit në Europë, një univers me shkronja civilike...

Sapo kishte dalë përmbledhja e gjerë “Shiu i fytirës time”, botim i editorit “Alma”, në kolanën e shkrimtarëve të Europës, ku janë përzgjedhur poezi të kohëve të ndryshme të Visarit, të paraburgut, të burgut dhe të pasburgut, si dhe poezi për Kosovën, edhe nga më të fundit, madje dhe që botohen për herë të parë.

Takimi i autorit me lexues, gazetarë dhe shkrimtarë serbë e të huaj u mbajt në mjediset e panairit, nën kamerën e televizionit kombëtar të Beogradit.

Në hapje dr. Gjore Otasheviç, presidenti i shtëpisë botuese “Alma”, tha që “poezia e Visar Zhitit është e jashtëzakonshme dhe e sjellë në serbisht nga Smajl Smaka në mënyrë mjeshtrore. Jemi të mrekulluar...”

“Visar Zhiti shkruan ashtu siç jeton”, – do të thoshte ndër të tjera në diskutimin e tij drejtuesi i kolanës së botimeve “Shkrimtarë nga Europa”, akademiku Milutin Gjuričković, redaktor i librit të Zhitit dhe autori i parathënies. Pastaj ai u hap në vlerat e poezive të përmbledhjes “Shiu i fytirës time”, duke theksuar se është një poezi e botuar dhe e njohur në Ballkan, e vlerësuar në Itali deri nga Umberto Eco, e përkthyer edhe në frëngjisht, gjermanisht, anglisht, e botuar në SHBA, deri dhe hebraisht e kinezisht etj., dhe u ndal edhe në vlerat e jetës së Visarit, nga ish-i burgosur politik në shkrimtar i njohur në vendin e tij dhe deputet e ministër Kulture.

Në takim u lexua edhe fjala e studiuesit, kritikut dhe poetit nga Kosova, prof. Agim Vinca, e cili e shikonte poezinë e Zhitit si dëshminë e një ecjeje të një uni kolektiv.

Pasi u recituan poezi nga libri, madje edhe nga ato me temë për Kosovën, Visar Zhiti, i ftuari nga Tirana posaçërisht për këtë veprimtari, pasi falënderoi për botimin dinjitoz të librit të tij dhe organizatorët e takimit, tha se vinte për herë të parë në Beograd, “edhe me druajtje, edhe me kërshtëri, edhe me gëzim në shkrimtarit për raste të tilla. Kufiri me ju ka qenë i ndaluar gjatë diktaturës, – vazhdoi Zhiti, – marrëdhëniet në shekuj janë tipike ballkanike, me drama, – dhe kujtoi se – ne në burgun e dikursheëm kishim të dënuar që ishin arratisur në Jugosllavinë e dikursheëm dhe sipas një marrëveshjeje të fshehtë e të keqe ata i kthenin, ku i dënonin rëndë... Tani kam ardhur unë me poezinë time, gjej një metropol kulture dhe ky takim, sipas meje, është edhe një metaforë e vyer, bashkohen poezi nga Tirana, me përkthyes nga Kosova dhe botues nga Beogradi, të shikojmë së bashku përpara”, – përfundoi fjalën e tij Zhiti, për të cilën u duartrokit dhe u vlerësua nga të pranishmit.

Shoqata e poetëve dhe përkthyesve të Malit të Zi i dha Visar Zhitit në ceremoninë e këtij takim çmimin e saj të veçantë për librin në serbisht “Shiu i fytirës time”, një risi me mesazhe kujtese dhe paqeje.

Takimi u mbyll me një koktej miqësor, teksa autori jepte autografe...

Më pas edhe një shëtitje nëpër Beograd, atje ku bashkohen lumenjtë Sava dhe Danubi, patjetër edhe

në rrugën historike “Shkodra”, që vendasit e quajnë “Skadarlije”, plot me turistë, rini dhe hare mbrëmjesore. Edhe libri i Visarit “Shiu i fytirës time” hapet me një poezi për këtë rrugë, ku kishte shëtitur edhe i biri i tij pas kthimit nga Barcelona, në takimin e fundit të Parlamentit European të të Rinjve.

Imazhi i një çasti të atillë frymëzoi piktorin e njohur me banim në Itali, Gjergj Kola, për të bërë disa punime në pikturë dhe njëra nga skicat shoqëronte poezinë.

Zëri që vjen nga dhimbjet e vetvetes, nga thellësitë e vuajtjes dhe dramet e atdheut është më i pranuari, kumt marrëveshjes mes kohëve dhe vendeve, ka brenda dashuri, profeci dhe paqe mes popujve...

Sipas “Lajmëtari i së mirës”

KAQ PRANË DHE TË NDARË
JU DUA TË GJITHËVE...
(Parathënia e librit “Shiu i fytirës time”)
Nga Dr. Milutin Gjuričković

“Ç’forcë e madhe është te njeriu,
që di të heshtë edhe kur ka të drejtë”.

Lev Tolstoj

Prallëkush nga poetët bashkëkohorë shqiptarë me arsye, natyrisht, ka përjetuar reputacion të tillë ndërkombëtar, siç është rasti me Visar Zhitin, poetin, prozatorin e njohur, shkrimtarin, eseistin, përkthyesin dhe disidentin politik i cili krejtësisht i pafajshëm është dënuar dhe është burgosur nëpër kazamatët dhjetë vite të plota. Pas daljes nga burgu ai ka pasur përkrahjen e shumë intelektualëve, të shkrimtarëve dhe të personaliteteve publike nga e gjithë bota, duke filluar që nga Umberto Eco, Sebastiano Grasso, Kevin

Higgins, Robert Elsi, madje edhe nga Filip Davidi ynë.

Opusi i tij letrar është shumështrësor dhe në aspektin zhanror i llojllojshëm. Pothuaj me sukses të njëjtë shprehet dhe dëshmohet në poezi, tregim, roman, ese, publicistikë dhe në përkthim. Është përkthyer në shumë gjuhë të huaja dhe është fitues i një sërë çmimesh në vendin e vet dhe botën e jashtme.

Para nesh është përzgjedhja komplekse e poezisë së Visar Zhitit, që nga përmbledhja e parë deri te libri i fundit poetik, që dëshmon në masë të mjaftueshme harkun zhvillimor poetik, metamorfozat krijimtare, ndikimet, gërshetimet lirike dhe mëvetësinë, autenticitetin e shprehjes.

Këto poezi, në fakt, në mënyrën më të mirë tregojnë sesi jeta dhe poezia gërshetohen reciprokisht dhe identifikohen, pa kurrfarë mistifikimesh apo mbindërtimi artistik. Ç’është e vërteta, poeti shkruan ashtu siç jeton dhe si ndien, respektivisht ashtu siç e përjeton botën e brendshme (psikologjike, etike) dhe të jashtme (fizike, historike), me të cilën ka shumë mosmarrëveshje, paqartësi dhe sfida.

Që në shikim të parë mund të hetohet se poezitë kanë varg të lirë, metrikë të thyer dhe dozë të caktuar narracioni, e cila e ndërlidhur me liriken, epiken dhe dramatiken i jep të gjithë përmbledhjes vulë të veçantë dhe rëndësi e kuptim artistik. Duke udhëtuar nëpër botë dhe duke takuar e njohur njerëz të rinj, vise dhe vende, Zhiti e shkruan një ditar të një lloji të veçantë të kujtimeve dhe të shtegtimeve, në të cilin ka edhe “Ilum të hidhur të përvojës”, siç do të thoshte Danilo Kishi, e që në radhë të parë ka të bëjë me burgosjen dhe izolimin krijues të tij. Disa poezi madje kanë atmosferë orveliane dhe kafkiane në sensin e simbolizimit të çuditshëm dhe të shprehjes së absurdit të kësaj bote.

Poezitë e tij nuk janë vetëm kryengritëse e plot revoltë dhe pezëm të pakënaqësisë, aq sa janë plot dashuri, njerëzillëk dhe falje (“Aq afër e të ndarë”). Ai, para së gjithash, është njeri dhe pas kësaj poet. Krijues me shpirt etik dhe me motiv mëmëdhetar, i cili di të falë dhe nuk urren askënd. Këtë e dëshmon edhe titulli i poezisë “Ju dua Ju të gjithëve”. Ai është kozmopolit, njeridashës i theksuar dhe vrojtues, analist dhe komentues, i cili urtësisht dhe stoikisht i përballon të gjitha padrejtësitë dhe krajetat të cilat e kanë goditur në jetë.

Duke e përjetuar tërë helmin e jetës, padrejtësitë e ndryshme, nënkëmbëzat, shantazhimet dhe të këqijat, poeti nuk ua kthen njësoj, veçse me gjerësinë, me spontanitetin e natyrshëm dhe me urtësi dëshiron që të gjitha këto t’i tejkalojë dhe të mos ia lërë harresës. Në këtë sens poezitë e tij janë gjurmë të papërsëritshme dhe dëshmi, gjegjësisht vraga shpirtërore dhe kujtime të dhimbshme të cilat edhe nuk harrohen aq shpejt.

Nuk është e tepërt të thuhet se disa poezi kanë, në njëfarë dore, kuptim testamentar, respektivisht amaneti se të gjitha mund të falen, por jo edhe të harrohen.

Më bëhet se poetika e Zhitit, filozofia jetësore dhe fenomenologjia e krijimtarisë është në përputhshme adekuate me qëndrimin e njohur të Rajner Marije Rilkes, i cili atëbotë kishte thënë:

*Kush flet për fitoren?
Të rezistosh është e tëra.*

Pra, nuk është e vështirë ta zbulosh dhe ta njohësh jetën e poetit dhe punën e tij, raportin e tij njerëzor dhe kozmopolit ndaj të gjithë njerëzve dhe vendeve të cilat i përmend dhe të cilat e preokupojnë fantazinë, kërshtërinë dhe vëmendjen e tij. Në këtë kontekst kanë lindur poezitë antologjike të cilat ia ka kushtuar djalit të tij, me rastin e qëndrimit në Beograd, në rrugën “Shkodra”.

Në saje të përkthimit të frymëzuar dhe të suksesshëm të Smajl Smakajt, kemi rastin që më plotësisht ta kundrojmë, në mënyrë kritike ta vlerësojmë dhe estetifikojmë ta njohim poezinë dhe poetikën e Visar Zhitit, e cila për shumëçka është e jashtëzakonshme, e veçantë, e vetvetishme dhe jetësisht e fuqishme.

Beograd, 25 qershor 2019
Përktheu nga origjinali Smajl Smaka



“LOLITA” NUK DO TË BOTOHEJ NËSE NABOKOVI DO TA KISHTE SHKRUAR TANI

nga Lara Waddell

Nëse ata që i përkasin brezit digjital janë tani midis moshës 22 dhe 36 vjeç, edhe unë i përkas këtij brezi, megjithëse jam në skalionin e atyre që anojnë nga të dytët, dhe përveç kësaj jam edhe botuese. Kjo është arsyeja pse kam vënë re me interes të veçantë kur njerëzit që nuk i përkasin brezit digjital dhe nuk punojnë në fushën e botimeve shprehin mendimin se “Lolita” e Vladimir Nabokovit nuk do të botohej kurrë në kohën

e sotme për shkak të të rinjve të tmerrshëm si unë. As pas një mijë vjetësh, thonë ata. Nuk do kishte fare shanse të botohej.

Kjo është një pikëpamje që shfaqet kaq shpesh sa të befason. Në revistën britanike “Spectator”, Rachel Johnson shkruante se “Lolita” në kohën tonë do flakej në grumbullin e dorëshkrimeve të refuzuara nëse Nabokovi do ta kishte shkruar tani, duke vënë në dyshim nëse ky roman klasik do

të bëhej pjesë e programeve arsimore. Ai natyrisht shpërfill faktin se romani është tashmë pjesë e programeve të tilla. Johnson më pas pyeti botuesin Dan Franklin, i cili është i dhënë pas rrjeteve sociale, por jo moshatar me pjesëtarët e brezit digjital, i cili u shpreh se nuk do ta botonte Lolitën sot nga frika se “një grupim 30 vjeçarësh” do të protestonte ndaj botimit për shkak të lëvizjeve të tilla si #MeToo dhe mediave sociale.

Ndërsa promovonte filmin e saj “Libraria” (The Bookshop) vitin e kaluar, aktori Emily Mortimer foli edhe për “shenjtërinë” e #MeToo, duke i thënë Telegrafit: “Lolita do ta kishte shumë të vështirë të botohej sot”. Dhe Twitter-i ofron një menu të gjithfarëllojshme për të shfrytëzuar frikërat më të fundit të puritanëve. Duke kritikuar ashpër “botimin në hapësirë të sigurt”, folësi i lajmeve televizive dhe gazetari Iain MacWhirter shkroi në Twitter: “Askush nuk do t’a botonte romanin “Paraja” (Money) të Martin Amis-it sot, një nga romanet më të mirë të shekullit të 20-të. Rrjedhimisht, as nuk mund të mendohet botimi i Nabokovit apo Bukovskit”.


Krahas paralajmërimeve në fillim të videove apo në ballinë të librave për përmbajtje shqetësuese dhe për hapësira të sigurta, lufta imagjinare mijëvjeçare ndaj “Lolitës” është bërë një klishe e veçantë kulturore e çuditshme. Mu si shkop për të na rrahur, por që është kalbur. Askush nga ata që bën deklaratat të tilla nuk duket se është konsultuar me ndonjërin nga të brezit digjital, por për më tepër, duket se nuk janë konsultuar as me Google-in. Për betejën e Nabokovit për ta botuar Lolitën në kohën e tij kanë njohuri të gjithë sot, dhe nuk është aspak e vështirë të mësosh nëse je kureshtar.

Kur Nabokovi mbaroi së shkruari romanin e tij në vitin 1953, ai u rropat të gjente një botues në SHBA për shkak të temës së pedofilisë për të cilën shkruhej në libër. U refuzua nga të gjitha shtëpitë e mëdha botuese, përfshirë shtëpinë botuese “Viking”, ku botuesi Pascal Covici tha se kushdo që do ta botonte rrezikonte të burgosej ose të gjobitej. Nabokovi iu drejtua shtëpisë botuese “Olympia Press”, shtëpi botuese franceze e njohur më shumë për botimin e letërsisë së bujshme pornografike. Por pas botimit në vitin 1955, Franca u bë e para në një varg vendesh që e ndaloi “Lolitën”, duke u ndjekur nga Argjentina, Zelanda e Re, Afrika e Jugut dhe Australia (ku censorët e mbajtën të ndaluar deri në vitin 1965). Një debat i nxehtë në Westminster çoi në sekuestrimin e të gjitha kopjeve nga dogana deri në vitin 1959, kur u lejua përfundimisht të botohej në Mbretërinë e Bashkuar, por aq e madhe ishte damkosja publike e librit sa botuesi i tij, deputeti konservator Nigel Nicolson, u detyrua të hiqte dorë nga posti.

Historia e vërtetë e botimit të Lolitës është shumë më interesante sesa përplasja e mërzitshme, e fesë së mbrapshtë të brezit digjital. Të shpallësh se “Lolita” nuk do të botohej kurrë në kohën tonë do të thotë të humbësh gjurmët; të shpallësh që jetojmë në një epokë të re dhe unike të zemërimit, gjë që e errëson puritanizmin e mirëfillt seksual dhe kundërshtimin e ashpër me të cilin libri u përball dekada më parë dhe shpërfill faktin sesa shumë kemi ecur përpara. Gjëja më serioze është të bërit njësh në mënyrë të qëllimshme e kundërshtimit ndaj abuzimit dhe ngacmimit seksual me përkorësinë fantastike dhe lehtësisht të shmangshme në lidhje me seksin.

E kam lexuar pjesën më të madhe të veprës së Nabokovit ku isha student. Madje, bleva shumë kollaj një kopje të “Lolitës”, në një librari të rregullt. Po, mund të jetë një roman që nuk është e lehtë ta lexosh, por është i shkruar bukur dhe kritikë e përhapur ndaj një njeriu grabitçar, manipulues. Në këtë kuptim, është roman mjaft i përshtatshëm në një epokë ku ne po hulumtojmë nuancat e pushtetit dhe të folurit në mënyrë të hapur për abuzimin seksual. Ndoshta lexuesit e sotëm do ta kuptojnë atë më shumë se kurrë më parë.

Përktheu Granit Zela
Botuar në “The Guardian”




IN MEMORIAM ALEKSANDER KOLI

Para pak ditësh, u nda nga jeta pas një sëmundje të rëndë, përkthyesi Aleksandër Koli. Familja e tij humbi njeriun e shtrenjtë, shoqëria, shokun dhe mikun me vyrtyte të larta njerëzore, ndërsa lexuesit e shumtë, përkthyesin e talentuar që bëri të flasin shqip një numër të konsiderueshëm veprash të letërsisë botërore.

E gjithë jeta e Aleksandër Kolit, nga rinia e tij, kur përfundoi shkollën e aviacionit dhe deri në ditën që u nda nga ajo, ishte një përkushtim për mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së njerëzve të rrezikuar nga fatkeqësitë. Ai do të kujtohet gjithmonë me respekt nga miqtë dhe shokët e tij të shumtë për mendimin e pjekur, për ndihmën e pakursyer dhe sakrificat që bëri gjatë operacioneve për shpëtimin e jetës së njerëzve.

Lexuesit e shumtë do ta kujtojnë me admirin mjeshtër që gdhendi aq bukur në gjuhën shqipe veprat e disa prej shkrimtarëve më të shquar të letërsisë botërore si: Mihail Bulgakov, Teodor Drajzer, Xhek London, O'Henry, Jeffrey Archer, Hektor Munro, Fitzroy Maclean, Somerset Muagham, Vladimir Sorokin, Ljudmilla Petrushevskaja, Shirley Konran, Artur K. Dojl, Sidney Sheldon, Pelham G. Wodehouse, Margaret Synge, Helene Gurber, Dina Rubina etj. Lista e librave dhe autorëve të përkthyer nga Aleksandër Koli është shumë e gjatë. Koli ishte njohës i shkëlqyer i gjuhëve anglisht dhe rusisht.

Petrit Ymeri, Gëzim Tafa, Bujar Hudhri, Mehmet Gëzhilli, Pandeli Koçi, Vasil Premçi, Nikolla Spathara, Basir Bushkashi, Kujtim Stana, Vladiit Bregu, Agron Sejardini, Maksim Cikuli, Astrit Jaupi, Sami Guzina, Gëzim Xhafa, Ndoc Selimi, Fredi Prifti, Trifon Llupo.



PËRSHËNDETJA E NËNËS

Tregim nga LJUDMILLA
PETRUSHEVSKAJA

Përktheu nga origjinali Aleksandër Koli



Olegu, një djalosh i ri, kur i vdiq e ëma mbeti jetim. Mbeti vetëm me motrën, ndërsa i ati ndonëse ishte ende gjallë, siç u sqarua më vonë, nuk i binte të ishte babai i tij. Babai i vërtetë ishte një burrë tjetër, me të cilin takohej shpesh e ëma, edhe pse ishte e martuar. Këtë gjë Olegu e mësoi më vonë, kur filloi të kalonte nëpër duar letrat e mamasë së vdekur, duke shpresuar se mos mësonte diçka më shumë rreth saj. Mes letrave ai gjeti edhe dokumentin, a më saktë një pusullë, ku ai burri i panjohur i shkruante se ishte familjar dhe nuk kishte të drejtë t'i braktiste të dy fëmijët e tij falë një fëmije të ardhshëm, i cili nuk dihej se i kujt mund të ishte. Në fund të pusullës ishte data. Me sa dukej, jo shumë kohë përpara lindjes, e ëma kishte dashur ta braktiste të shoqin e të martohej me këtë burrin tjetër dhe kuptohet, gjithçka qëndronte vërtet ashtu siç kishte aluduar një herë ligësisht dhe në mënyrë hakmarrëse motra e tij e madhe, gjatë një bisede me Olegun.

Pasi zbuloi pusullën, djaloshi nisi t'i kalonte

me të shpejtë nëpër duar letrat e tjera dhe mes tyre gjeti një pako të zezë me fotografi, në të cilat e ëma kishte dalë zhveshur në pozicione të ndryshme, duke përfshirë edhe disa poza krejt lakuriq. Të gjitha këto ishin fotografuar si në një skenë, ku e ëma, madje edhe në pozimet nudo, mbante hedhur krahëve një shall të gjatë. Të gjitha këto ishin një goditje tepër e rëndë për djaloshin e ri. Ai dëgjoi nga të afërmit se në rininë e hershme, e ëma përmendej për bukurinë e saj, por tashmë në këto fotografi, ajo dukej si një tridhjetë e pesëvjeçare, ende e fortë, por jo më aq e bukur, thjesht, një grua e mbajtur mjaft mirë. Pas kësaj goditjeje, djaloshi ishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç—e la shkollën, braktisi gjithçka dhe përgjatë dy viteve, deri përpara ushtrisë, nuk bëri asgjë, nuk dëgjonte asnjëri, në shtëpi hante çfarë gjente në frigorifer, ikte, kur i ati dhe e motra vinin në shtëpi, kthehej, kur ata flinin.

Ai arriti deri në një shkatërrim nervor dhe fizik të tillë, sa i ati u detyrua të ushtronte ndikimin e tij për t'i siguruar të birit një kontroll në komisionin

mjekësor të punës, në mënyrë që t'i caktonin një pension për skizofreni, por pikërisht ditën e fundit, përpara vajtjes në komision, i ati dha shpirt natën në shtrat dhe gjithçka mori të tatëpjetën. Pas kësaj, pa e zgatur shumë, e motra ndërroi apartamentin, duke e lënë të vetmuar vëllain në dhomën e tij dhe Olegun nuk vonuan ta merrnin në ushtri.

Atje, Olegut i ndodhi një ngjarje: bashkë me disa ushtarë të tjerë, atë e vendosën të ruante monopatin e një qafe mali, përmes së cilës duhej të kalonte një i arratisur nga kolonia e të burgosurve. Po bëhej tashmë një muaj që ky njeri endej i lirë, dhe në rrugëtimin e tij kishte arritur të vriste pesë veta, mes të cilëve edhe një vajzë. Tani i ishte afruar qafës së vetme malore, përmes së cilës kalonte rruga drejt "Tokës së Madhe", domethënë, pjesës europiane të Rusisë. Sipas të gjitha njoftimeve, i dënuari nuk do të dukej edhe aq shpejt tek ai shteg, megjithatë, si parapritje, pusinë e ngritën tre ditë më parë, ngaqë nuk i dihej se çfarë mjete transporti mund të shfrytëzonte i arratisuri.

Në pritë zunë vende, Olegu, rreshteri dhe tre ushtarë të tjerë. Ata rrinin roje pas një shkëmbi të madh, duke mbështetur atje automatikët. Aty ndërroreshin me radhë dhe pikërisht, gjatë kohës që bënte roje Olegu, te shtegu u duk një burrë. Ai ngjasonte me fotografinë e të arratisurit, të cilën ua kishin treguar eprorët që më parë. Olegu nuk u përmbajt dhe e qëllloi, por pastaj doli se ky paskesh qenë dikush tjetër, një ish i burgosur, i cili e kishte kryer dënimin dhe tani po kthehej në Rusi, te shtëpia e tij, ndonëse ilegalisht, ngaqë nuk kishte leje për t'u endur nga vendi në vend.

Kriminelin e vërtetë tashmë e kishin kapur te një shtegkalim tjetër diku pranë. Komanda u soll mirë ndaj Olegut, e deklaruan përkohësisht me të meta mendore, e shtruan në spital dhe më pas e liruan si të paafte për vazhdimin e mëtejshëm të shërbimit ushtarak. Kjo gjë atij i doli për më mbarë, ngaqë flitej se gruaja e njeriut të vvarë, nuk la vend pa e kërkuar ushtarin anormal, i cili ia qëllloi të shoqin vetëm e vetëm ngaqë shkeli disa hapa pa leje kufirin e fshatit të tij—sepse nëpër atë shtegkalim kalonte vija ndarëse administrative e qarkut.

Olegu u kthye në shtëpi. Tashmë ishte thuhet krejt i shogët, dhëmbët i patën rënë njëri pas tjetrit, nuk kishte asgjë për të ngrënë, nuk kishte asgjë me se të merrej, i mbetej veç të shkonte e të punonte, ndonëse pa asnjë lloj arsimit.

Mirëpo, krejt papritur, në jetën e tij u shfaq e motra, e cila i mori në duart e saj të gjitha punët. Ajo e rregulloi Olegun në teknikum, i pastronte

dhomën, i sillte ushqime ose para, edhe pse nuk ishte plotësisht motër gjaku me të dhe më parë nuk e kishte dashur asnjëherë. Njëherë, në mbrëmje, kur po bëhej gati të largohej, mes të tjerash, ajo i tha:

- Ti nuk duhet t'i besosh ato që të kam thënë dikur për nënën tonë. Babai ynë ka qenë njeri shumë dyshues. Ishte tip i rëndë dhe mund të luante mendsh kë të donte.

Pastaj ajo doli jashtë.

Pas largimit të motrës, Olegu hapi valixhen dhe filloi të rrëmonte nëpër shkresurinat ku ndodhej letra, por aty gjeti vetëm zarfin, me fotografitë e varrimit të nënës. Tek ajo pakoja e errët, ku ai priste të shihte fotografitë nudo të nënës, tani ndodhej veçse një fije e rrudhosur letre e zezë, shumë e vjetëruar dhe, kur Olegu nisi ta nxirrte, ajo iu shkërmoq në dorë, duke u bërë menjëherë pluhur.

Ai nisi t'i shqyrtonte shkresurinat, dhe kudo lexonte letra të nënës drejtuar të atit, në të cilat shkruhej për dashurinë, për besnikërinë, për Olegun dhe sa i ngjante ai babait.

Olegu ngashëreu tërë mbrëmjen, lotët i derdheshin pa dashje nga sytë, ndërsa ditën tjetër në mëngjes nisi të priste derisa t'i vinte e motra, në mënyrë që t'i rrëfente sesi kishte shkalluar nga mendtë në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare dhe si kishte përfytyruar gjëra të paqena, madje nga ky shkak kishte vrarë një njeri, i cili nuk i ngjante aspak fotografisë, sipas së cilës duhej ta kishte njohur.

Motra nuk i erdhi më kurrë. Me sa dukej, e kishte harruar të vëllain dhe pas disa kohësh edhe ai e harroi, ngaqë ishte mjaft i zënë me jetën e tij të re. Pasi mbaroi teknikumin, ai vazhdoi institutin, u martua dhe u bë me fëmijë.

Ndonëse Olegu ishte syzi dhe e shoqja një zeshkane syzezë, për çudi, të dy fëmijët u dolën flokëverdhtë dhe me syçka bojëqielli-pikë për pikë si gjyshja e tyre, e ëma e tij e vdekur.

Njëherë, papritur, gruaja i propozoi të shkonin te varri i nënës së tij. Atë e gjetën me vështirësi, në varrezën e vjetër pllakat përkujtimore ngriheshin jashtëzakonisht ngjeshur pranë njëra-tjetrës dhe ngjitur me varrin e s'ëmës, u duk papritur një pllakë e dytë, paksa më e vogël.

- Me siguri e babait, - tha Olegu, i cili nuk kishte qenë në varrimin e të atit.

- Jo, lexoje, kjo është e motrës tënde të një gjaku, - iu përgjigj e shoqja.

Olegu u tmerrua që kishte arritur ta harronte kështu të motrën. Ai u përkul mbi pllakë dhe lexoi mbishkrimin. Kjo ishte vërtet e së motrës.

- Vetëm se, datën e vdekjes më duket që e kanë ngatërruar, - tha ai. - Motra erdhi tek unë shumë më vonë se kjo datë vdekjeje, kur isha kthyer nga ushtria. Se, të kam treguar, që ajo më ngriti në këmbë, ajo më riktheu vërtet në jetë. Unë isha i ri dhe shkalloja mendsh edhe për vogëlsira.

- Kjo gjë nuk ndodh, këtu datat nuk i ngatërrojnë kurrë, - iu përgjigj e shoqja. - Je ti ai që i ke ngatërruar. Në çfarë viti u ktheve nga ushtria?

Dhe ata nisën debatonin, duke qëndruar te cepi i varrit të braktisur dhe i lënë pas dore. Bari i egër që ishte rritur i harlisur gjatë verës, u arrinte deri te gjunjët. Më në fund, të dy burrë e grua nisën ta shkulin atë.- Avioni nuk mund të fluturojë më asgjëkund, - ia ktheu piloti.

Koloneli nxori pistoletën dhe e kërcënoi pilotin se do ta vriste në vend, për moszbatim urdhëri.

Por piloti mbajti një qëndrim shpërfillës dhe i vazhdoi përpjekjet për ta ngritur kërcurin mbi tokë, herë në njërin anë, herë në anën tjetër, me fjalët:

- Hë, jepi tani, eja të shkojmë.

Koloneli shtiu, por siç duket gaboi shenjë, sepse piloti vazhdonte të mërmëriste si më parë:

- Eja të shkojmë, eja të shkojmë.



Ndërkohë jehuan gumëzhima makinash dhe në fushë u shfaq autokolona e kamionëve me ushtarë gjermanë.

Koloneli u fsheh mes barit mbas një çuke të vogël, kamionët vijonin të vinin pa mbarim, por nuk u dëgjuan as të shtëna, as komanda dhe as ndalim motorësh. Pas dhjetë minutave, makinat kaluan, koloneli ngriti kokën – piloti, si edhe më parë, vazhdonte të merrej me kërcurin e djegur, ndërsa atje larg, pranë zjarrit, njerëzit rrinin ulur a shtrirë, ose endeshin andej-këtej.

Koloneli u ngrit dhe u afrua te zjarri. Atje, rreth e rrotull nuk njohu askënd, sepse ky nuk ishte aspak regjimenti i tij. Këtu gjendeshin edhe ushtarë këmbësorie, edhe artilierë, edhe një Zot e di çfarë tjetër, të gjithë me uniforma të grisura, me plagë të hapura nëpër krahë, në këmbë ose në bark. Vetëm fytyrat i kishin të kthjellëta.

Njerëzit bisedonin me zë të ulët. Pranë zjarrit, e kthyer me shpinë nga koloneli, rrinte ulur një grua me kostum të errët civil dhe shami në kokë.

- Kush është këtu me gradën më të lartë, të raportojë situatën, - kërkoi koloneli.

Askush nuk lëvizi, askush nuk i kushtoi vëmendje oficerit, kur ai filloi të shtinte, mirëpo, kur piloti tërhoqi pranë zjarrit kërcurin e djegur, të gjithë e ndihmuan që ta hidhte në zjarr “shturmanin” e tij, siç e quante, dhe nga kjo gjë flaka u fik. U bë krejt errësirë.

Koloneli dridhej i tëri nga i ftohti dhe nisi të shante e të thoshte se tani ishte krejt e pamundur të ngroheshin, ngaqë zjarri nuk do të ndizej prej këtij kërcuri.

Dhe atë çast, gruaja, pa u kthyer, tha:

- Përse më vështrove? Përse ma ngrite vellon? Tani, do të të thahet dora.

Ky ishte zëri i së shoqes.

Koloneli humbi ndjenjat dhe, kur u përmend, pa se gjendej në spital. Atij i thanë se e kishin gjetur te varrezat, pranë varrit të së shoqes dhe se krah u mbi të cilin kishte ndenjur shtrirë, i ishte dëmtuar rëndë dhe tani kishte mundësi t'ia hiqnin.

MIRA MEKSI diktatori në kryq



OnufriRoman